



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E EKONOMISË
DHE INOVACIONIT**

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TË BIZNESIT DHE INVESTIMEVE 2021 – 2027

RAPORT MONITORIMI, 2025

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 466, datë 30.7.2021 “Për miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve, 2021– 2027, dhe të planit të saj të veprimit”

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 501, datë 10.9.2025 “Për disa ndryshime në Vendimin Nr. 466, datë 30.7.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe investimeve, 2021– 2027, dhe të planit të saj të veprimit”

RAPORT MONITORIMI 2025

Tabela e përmbajtjes

I. Informacion përmbledhës mbi monitorimin e “Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2021 – 2027 (SBZHI)” për vitin 2025.....	3
II. Impakti i implementimit të strategjisë në përputhje me axhendën e Integritit European dhe shkalla e zbatimit	4
III. Ekzekutimi i përgjithshëm i buxhetit	5
IV. Vlerësimi sipas secilit objektiv / masë duke përdorur treguesit.....	6
I. Objektivi specifik 1.1: “Tërheqja e investimeve dhe ndërkombëtarizimi”.....	6
1.1.1 Masa “Promovimi /lehtësimi sistematik i investimeve të synuara”	6
1.1.2 Masa “Program i strukturuar për shërbimin e përkujdesjes së mëtejshme”	11
1.1.3 Masa “Vlerësimi dhe reforma e programit të TEDA-ve”	17
1.1.4 Masa “Programi i eksporteve”	19
1.1.5 Masa “Iniciativa e zhvillimit të biznesit elektronik”	21
1.1.6 Masa “Vlerësimi i modelit të diplomacisë ekonomike”	22
II. Objektivi specifik 1.2: “Zhvillimi i NMVM-ve, sipërmarrja dhe inovacioni”	23
1.2.1 Masa “Lidhja mes NMVM-ve dhe startup-eve”	23
1.2.2 Masa “Aksesi në programet e Bashkimit Evropian në fushën e biznesit”	24
1.2.3 Masa “Integrimi ndërkombëtar i ekosistemit të startup eve”.....	26
1.2.4 Masa “Nisma për përmirësimin e zinxhirit të vlerës së bazuar në konkurrencë”	27
1.2.5 Masa “Rritje e aksesit në financë për NMVM-të”	28
1.2.6 Masa “Program për aftësitë sipërmarrëse për NMVM-të”	31
III. Objektivi specifik 1.3: Zhvillimi i kapitalit njerëzor	33
1.3.1 Masa “Skema e mbështetjes për zhvillimin e kapitalit njerëzor bashkëpunues”	33
1.3.2 Masa “Sensibilizimi dhe përfshirja e bizneseve në reformat e sistemit të VET-së”	33
1.3.3 Masa “Sistemi i parashikimit të nevojave për aftësi”	35
1.3.4 Masa “Vlerësim periodik i nevojave për trajnim”	36
V. Vlerësimi i shkallës së zbatimit të Strategjisë (SBZHI) për vitin 2025.....	37

I. Informacion përmbledhës mbi monitorimin e “Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2021 – 2027 (SBZHI)” për vitin 2025

Përmbledhje e Monitorimit të Strategjisë SBZHI – Viti 2025

Gjatë vitit 2025, zbatimi i Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve është fokusuar në forcimin e pozicionit të Shqipërisë si një destinacion konkurrues për investimet e huaja direkte (IHD), mbështetjen e ndërkombëtarizimit të bizneseve vendase dhe zhvillimin e kapitalit njerëzor.

1. Tërheqja e Investimeve dhe Ndërkombëtarizimi

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ) kanë intensifikuar përpjekjet për promovimin e vendit përmes fushatave të synuara (*outreach*) dhe diplomacisë ekonomike.

- ✓ **Fushata Outreach:** Janë realizuar dy fushata specifike në sektorë me vlerë të shtuar: ICT/BPO dhe manifaktura e pajisjeve mjekësore. Pjesëmarrja në panairin ndërkombëtar MEDICA në Gjermani rezultoi në rreth 15 takime direkte me kompani të interesuara.
- ✓ **Diplomacia Ekonomike:** MEPJ ka koordinuar pjesëmarrjen e Shqipërisë në forume dhe panaire globale si *ITB Berlin 2025*, ku Shqipëria u shpall “Vendi i Nderit”, duke rritur ndjeshëm dukshmërinë e potencialit ekonomik dhe turistik të vendit.
- ✓ **Kapacitetet teknike:** Që prej shtatorit 2025, AIDA është abonuar në platformën *FDI Market*, duke përmirësuar procesin e identifikimit të investitorëve përmes të dhënave të strukturuar mbi projektet *greenfield* dhe flukset globale të IHD-ve.

2. Mbështetja e Eksporteve dhe Digjitalizimi

Një arritje kryesore për vitin 2025 është miratimi i Programit për Nxitjen dhe Lehtësimin e Eksporteve 2026-2030.

- ✓ **Platforma e Eksporteve:** Është vënë në funksion platforma “*exportalbania.al*”, ku deri në fund të 2025 janë regjistruar 155 kompani eksportuese. Në periudhën dhjetor 2025 – janar 2026, platforma regjistroi mbi 4,500 vizitorë.
- ✓ **E-commerce:** AIDA publikoi udhëzuesin “Si të nisësh një Biznes e-commerce” për t’u shërbyer NMVM-ve dhe Startup-eve në procesin e tyre të digjitalizimit.

3. Shërbimi Aftercare dhe Bashkëpunimi Rajonal

- ✓ **Përkujdesja ndaj Investitorit:** Përmes nismës “Investor Support Days” dhe takimeve *door-to-door*, AIDA ka kontaktuar gjithsej 112 kompani gjatë 2025, duke adresuar problematikat e tyre në bashkëpunimin me qeverisjen qendrore dhe vendore.
- ✓ **Rrjeti i Bashkëpunimit:** Janë nënshkruar memorandume të rëndësishme bashkëpunimi me agjenci homologe si *Invest North Macedonia*, *RAS (Serbi)*, *FIPA (Bosnjë dhe Hercegovinë)* dhe *SIMEST (Itali)*, me synim forcimin e investimeve rajonale dhe dypalëshe.

4. Aksesimi në Financë dhe Zhvillimi i Aftësive

- ✓ **Portali “Akses në Financë”:** Në platformën “one-stop-shop” ka regjistruar mbi 316 mijë angazhime totale gjatë 2025, duke ofruar informacion për rreth 48 thirrje për grante dhe financime.

- ✓ **Trajnime:** Janë realizuar 12 aktivitete në kuadër të projektit EEN 2025 dhe trajnime specifike për gatishmërinë për eksport me pjesëmarrjen e rreth 60 bizneseve.
- ✓ **Parashikimi i Nevojave:** Është finalizuar Studimi i Nevojave për Aftësi (SNA), i cili pritet të publikohet së shpejti për të orientuar politikatat e formimit profesional.

5. Inovacioni dhe Zonat Ekonomike (TEDA)

- ✓ **Durana Tech Park:** Viti 2025 shënoi operimin virtual të këtij parku teknologjik, duke u fokusuar në ngritjen e ekosistemit përpara ndërtimit fizik të infrastrukturës.
- ✓ **Financimi i Inovacionit:** AKKSHI ka financuar 14 projekte të Teknologjisë dhe Inovacionit (PTI) që synojnë bashkëpunimin mes universiteteve dhe biznesit.

II. Impakti i implementimit të strategjisë në përputhje me axhendën e Integritimit Evropian dhe shkalla e zbatimit

Implementimi i Strategjisë SBZHI gjatë vitit 2025 ka shërbyer si një instrument kyç për përafrimin e kuadrit rregullator dhe ekonomik të Shqipërisë me standardet e Bashkimit Evropian. Ky proces është i ndërlidhur drejtpërdrejt me reformat në kuadër të kapitullit 20 të integritimit evropian, në fushat e politikave industrial dhe sipërmarrjes.

1. Harmonizimi me Kapitullin 20 (Politika industriale dhe ndërmarrjet)

Strategjia ka patur një impakt të drejtpërdrejtë në përmbushjen e rekomandimeve të Raportit të Progresit të Komisionit Evropian përmes:

- ✓ **Përmirësimi të mjedisit të biznesit:** Reduktimi i barrierave administrative dhe digjitalizimi i shërbimeve për NMVM-të (përmes portaleve si “Akses në Financë”) reflekton parimet e “Small Business Act” të BE-së.
- ✓ **Mbështetjes për Inovacionin:** Zhvillimi i ekosistemit të Startup-eve dhe funksionalizimi i parqeve teknologjike (si Durana Tech Park) janë aktivitete në përputhje me Agjendën e Re Evropiane për Inovacionin.

2. Ndërlidhja me Planin e Rritjes (Growth Plan) për Ballkanin Perëndimor

Gjatë vitit 2025, masat e parashikuara në SBZHI kanë kontribuar në shtyllat kryesore të Planit të Rritjes së BE-së:

- ✓ **Integrimi në Tregun e Përbashkët:** Përmes programeve të mbështetjes së eksporteve dhe platformës *exportalbania.al*, bizneset shqiptare po përgatiten për standardet e cilësisë dhe konkurrueshmërinë që nevojiten në tregun evropian.
- ✓ **Konvergjenca Ekonomike:** Nxitja e investimeve të huaja direkte (IHD) në sektorë me vlerë të shtuar (ICT, Pajisje Mjekësore) synon ngushtimin e hendekut ekonomik me vendet anëtare të BE-së.

3. Ndërkombëtarizimi dhe Standardet e Shërbimeve

- ✓ **Rrjeti Evropian i Ndërmarrjeve (EEN):** Pjesëmarrja aktive në rrjetin EEN gjatë vitit 2025 i ka mundësuar bizneseve vendase të kenë akses në partneritete ndërkombëtare për integrimin në zinxhirët globalë të vlerës.

- ✓ **Diplomacia Ekonomike:** Aktivitetet e bashkëpunimit të AIDA-s me misionet diplomatike jashtë vendit ka rritur profilin e Shqipërisë si një ekonomi tregu funksionale, një kusht bazë ky për anëtarësimin në BE.

4. Zhvillimi i Qëndrueshëm dhe Digjitalizimi (Twin Transition)

Në përputhje me Axhendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor, implementimi i strategjisë gjatë këtij viti ka vënë theksin te:

- ✓ **Tranzicioni i Gjelbër:** Nxitja e investimeve që respektojnë standardet mjedisore të BE-së.
- ✓ **Transformimi Digjital:** Rritja e kapaciteteve absorbuese të bizneseve për teknologjitë e reja, duke kontribuar në një ekonomi më eficiente dhe transparente.

III. Ekzekutimi i përgjithshëm i buxhetit

Për vitin 2025, financimi i masave dhe aktiviteteve të parashikuara në Strategjinë e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve (SBZHI) 2021–2027 është realizuar përmes një kombinimi të burimeve të buxhetit të shtetit dhe mbështetjes nga partnerët për zhvillim (donatorët).


Alokimi sipas burimeve të financimit: Zbatimi për këtë periudhë ka ndjekur prioritetet e rishikuara të Planit të Veprimit, me fokus të veçantë të digjitalizimi i shërbimeve për biznesin dhe promovimi i investimeve. Kostot operative dhe administrative të institucioneve zbatuese janë mbuluar nga fondet programore vjetore. Këto fonde kanë financuar kryesisht pagat e stafit të dedikuar, mirëmbajtjen e platformave ekzistuese dhe aktivitetet e diplomacisë ekonomike. Mbështetja e partnerëve për zhvillim është orientuar drejt asistencës teknike për hartimin e programeve të reja (si psh Eksporteve 2026-2030) dhe rritjes së kapaciteteve absorbuese të NMVM-ve.

Shpërndarja sipas Objektivave Strategjike: Ekzekutimi i fondeve është reflektuar në tre shtyllat kryesore si vijon:

- ✓ **Promovimi i Investimeve dhe IHD-ve:** Janë ekzekutuar fonde për pjesëmarrjen në panairë ndërkombëtare (si ITB Berlin dhe MEDICA) dhe për abonimin në databaza të specializuara për investimet (si *FDI Market*).
- ✓ **Mbështetja për NMVM-të dhe Inovacionin:** Funkcionimin e portalit “Akses në Financë” dhe grantet e akorduara përmes AKKSHI-t për projektet e inovacionit.
- ✓ **Kapitali Njerëzor:** Një pjesë e buxhetit është alokuar për studimet e nevojave për aftësi dhe trajnimet e realizuara në kuadër të rrjetit EEN.

Në bazë të VKM nr. 466, datë 30.7.2021 “Për miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve, 2021– 2027, dhe të planit të saj të veprimit”, shpenzimet e buxhetuara për vitin 2025 paraqiten në grafikun nr. 1 si vijon:

Grafiku nr. 1: Shpenzimet e planifikuara për SBZHI për vitin 2025



Një tregues i rëndësishëm i mirëmenaxhimit të burimeve gjatë vitit 2025 janë masat e zbatuara nga Agjencia Startup Albania. Ndonëse fillimisht këto aktivitete ishin parashikuar të mbuloreshin përmes instrumentit “hendek financiar” (mbështetjes së jashtme), ato janë realizuar përmes kapaciteteve të brendshme të Agjencisë. Sa i takon masës për ofrimin e subvencioneve për NMVM-të dhe universitetet, e cila synonte mbështetjen e pagave dhe pajisjeve për kërkim-zhvillim, konstatohet se kjo masë nuk është realizuar gjatë vitit 2025. Ndonëse kjo ndërhyrje ishte parashikuar të financohej përmes mbulimit të hendekut financiar (fondet e donatorëve), mungesa e sigurimit të këtyre burimeve të jashtme ka sjellë mospërbushjen e aktivitetit.

IV. Vlerësimi sipas secilit objektiv / masë duke përdorur treguesit

I. Objektivi specifik 1.1: “Tërheqja e investimeve dhe ndërkombëtarizimi”

1.1.1 Masa “Promovimi /lehtësimi sistematik i investimeve të synuara”

Institucioni udhëheqës: Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA)

Institucione kontribues:

- Ministria përgjegjëse për ekonominë,
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme,
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë,
- Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit,
- Ministria e Mjedisit,
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural,
- Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë dhe shoqatat e biznesit.

Aktiviteti 1.1.1.1 : “Zbatimi i fushatave informuese specifike për grupet e synuara (investime me mjetet e nevojshme të IT-së)”

Gjatë vitit 2025, AIDA rishikoi fokusin e grupit të synuar dhe ndërmoi hapa konkretë për ndërtimin e një strategjie koherente të promovimit të investimeve, përmes organizimit të dy

fushatave të dedikuara outreach në sektorë prioritarë: ICT/BPO dhe manifaktura e pajisjeve mjekësore.

Si rezultat, AIDA arriti të forcojë pozicionimin e Shqipërisë si destinacion konkurrues për investime në sektorë me vlerë të shtuar, të krijojë një portofol të konsoliduar kontaktesh dhe të nisë një proces të strukturuar folloë-up-i me investitorët e interesuar, përfshirë organizimin e takimeve të mëtejshme online me kompani të identifikuara.

Me qëllim rritjen e kapaciteteve analitike dhe përmirësimin e procesit të identifikimit dhe targetimit të investitorëve të huaj, që prej shtatorit 2025 AIDA është abonuar në platformën FDI Market. Kjo platformë ofron informacion të strukturuar dhe të përditësuar mbi flukset globale të IHD-ve, projektet greenfield, sektorët prioritarë dhe vendimmarrjen e investitorëve ndërkombëtarë.

Përdorimi i këtij instrumenti analitik ka forcuar bazën informative për mbështetjen e vendimmarrjes strategjike, orientimin e prioritetëve sektoriale dhe planifikimin e aktiviteteve të promovimit dhe tërheqjes së investimeve në përputhje me objektivat e zhvillimit ekonomik të vendit.

Aktivitete të realizuara nga MEPJ:

Gjatë vitit 2025, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ), përmes Drejtorisë së Diplomacisë Ekonomike, Kulturore dhe Diasporës (DDEKD) dhe përfaqësive diplomatike, intensifikoi, koordinoi, mbështeti dhe nxiti zbatimin e aktiviteteve dhe masave në fushën e diplomacisë ekonomike, kulturore dhe të diasporës, në përputhje me objektivat e Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2021–2027 dhe prioritetet strategjike të politikës së jashtme të Republikës së Shqipërisë.

Aktivitetet u fokusuan në promovimin e interesave ekonomike kombëtare, rritjen e dukshmërisë ndërkombëtare të Shqipërisë si destinacion investimi dhe turistik, forcimin e partneriteteve ekonomike dypalëshe dhe shumëpalëshe, nxitjen e eksporteve dhe mbështetjen e procesit të integritetit evropian.

Diplomacia ekonomike, kulturore dhe e diasporës u zhvilluan në mënyrë komplementare dhe të integruar, duke krijuar sinergji ndërmjet zhvillimit ekonomik, diplomacisë publike dhe promovimit të identitetit kombëtar, si dhe duke kontribuar në forcimin e imazhit ndërkombëtar të Shqipërisë dhe rritjen e bashkëpunimit dypalësh dhe shumëpalësh. Pjesëmarrja në panaire, forume dhe samite u koordinua ngushtë me institucionet përgjegjëse kombëtare, aktorët e sektorit privat dhe përfaqësitë diplomatike.

Aktivitetet kryesore në 2025 janë si vijon:

➤ Promovimi ndërkombëtar dhe pjesëmarrja në panaire, forume dhe samite

MEPJ koordinoi dhe mbështeti pjesëmarrjen e Shqipërisë në një numër të konsiderueshëm panairësh, forumeve dhe samiteve ekonomike, tregtare, turistike dhe tematike në Europë, Azi, Lindjen e Mesme dhe Amerikën e Veriut.

Këto aktivitete shërbyen si platforma kryesore për promovimin e potencialit ekonomik të Shqipërisë, nxitjen e investimeve të huaja direkte, lidhjen e prodhuesve shqiptarë me rrjetet globale të tregtisë dhe promovimin e produkteve “Made in Albania”, veçanërisht në sektorët agro-ushqimor, turizëm, energji, teknologji dhe industri kreative.

Ndër aktivitetet kryesore të pjesëmarrjes dhe promovimit ndërkombëtar përfshihen:

- ITB Berlin 2025, ku Shqipëria u shpall “Vendi i Nderit”, duke siguruar një platformë të jashtëzakonshme promovimi për turizmin dhe ekonominë shqiptare;

- Global Food Forum (GFFA) në Gjermani;
- VINEXPO Paris dhe BIOFACH Nuremberg për promovimin e produkteve agro-ushqimore;
- World Governments Summit dhe Investopia Abu Dhabi; Abu Dhabi Sustainability Week;
- Panaire turistike dhe agro-ushqimore si FITUR në Madrid, Matka Travel Fair në Helsinki, Panairi Ndërkombëtar i Tregtisë në Dhaka, panaire në Toronto, Paris dhe Athinë;
- Samite ekonomike, teknologjike dhe investuese në Turqi, Katar, Indi dhe vende të tjera prioritare.

Këto aktivitete shërbyen si platforma strategjike për:

- promovimin e potencialit ekonomik dhe investues të Shqipërisë;
- nxitjen e investimeve të huaja direkte;
- lidhjen e prodhuesve shqiptarë me rrjetet globale të tregtisë;
- promovimin e produkteve “Made in Albania”, veçanërisht në sektorët agro-ushqimor, turizëm, energji, teknologji, industri kreative dhe shërbim

➤ **Ndërmjetësimi për investime dhe partneritete ekonomike**

Përfaqësitë diplomatike shqiptare luajtën rol aktiv në ndërmjetësimin e interesave për investime dhe partneritete ekonomike, duke adresuar kërkesa konkrete nga kompani dhe grupe investitorësh ndërkombëtarë.

Sektorët prioritarë të interesit përfshinë:

- energjinë e rinovueshme dhe efikasitetin energjetik;
- turizmin dhe hotelerinë;
- infrastrukturën dhe transportin;
- industrinë përpunuese;
- sektorin agro-ushqimor;
- teknologjinë dhe inovacionin;
- logjistikën dhe shërbimet digjitale;
- arsimin dhe formimin profesional.

Interesat për bashkëpunim u adresuan në koordinim me institucionet përgjegjëse kombëtare (MEI, AIDA, ministritë sektoriale dhe agjencitë përkatëse), duke lehtësuar organizimin e takimeve B2B, vizitave eksploruese dhe prezantimin e projekteve investuese, si dhe duke kontribuar në forcimin

e rolit të diplomacisë ekonomike si kanal konkret ndërmjetësi dhe lehtësimi për bashkëpunimin ekonomik ndërkombëtar.

➤ **Promovimi i eksporteve dhe produkteve shqiptare**

MEPJ dhe përfaqësitë diplomatike mbështetën iniciativa të shumta për promovimin e produkteve shqiptare në tregjet ndërkombëtare, veçanërisht në sektorin agro-ushqimor dhe të pijeve, duke përfshirë:

- verërat shqiptare;
- vajin e ullirit;
- bimët medicinale dhe aromatike;
- produktet ushqimore të përpunuara dhe pijet.

Përmes pjesëmarrjes në panaire ndërkombëtare, kontakteve me rrjete tregtare globale dhe aktiviteteve promovuese, prodhuesit shqiptarë u lidhën me partnerë tregtarë dhe distributorë ndërkombëtarë, duke kontribuar në rritjen e potencialit eksportues, diversifikimin e tregjeve të eksportit dhe integrimin në zinxhirët globalë të vlerës.

➤ **Forcimi i bashkëpunimit ekonomik dypalësh dhe shumëpalësh**

MEPJ kontribuoi në forcimin e bashkëpunimit ekonomik dypalësh me partnerë kryesorë si Gjermania, Greqia, Italia, vendet e Gjirit dhe partnerë të Bashkimit Evropian, përmes:

- forumeve ekonomike;
- vizitave të nivelit të lartë;
- komisioneve të përbashkëta ekonomike;
- dialogut institucional për adresimin e barrierave tregtare dhe procedurale.

Këto mekanizma kontribuan në krijimin e kushteve më të favorshme për investime, tregti dhe bashkëpunim industrial dhe teknologjik.

➤ **Transporti ajror si instrument i diplomacisë ekonomike dhe turistike**

Transporti ajror u identifikua si instrument kyç i diplomacisë ekonomike dhe turistike, me fokus në:

- zgjerimin e rrjetit të linjave ajrore direkte;
- rritjen e frekuencave të fluturimeve;
- negociimin e marrëveshjeve të reja ajrore;
- përmirësimin e aksesueshmërisë së Shqipërisë për turistë dhe investitorë.

Këto masa kontribuan në uljen e kostove të udhëtimit, rritjen e flukseve turistike dhe forcimin e lidhjeve ekonomike me tregjet prioritare.

Aktiviteti 1.1.1.2: Rishikimi i fokusit të grupit të synuar dhe përgatitja e një strategjie koherente të promovimit të investimeve

Gjatë vitit 2025, AIDA organizoi dy fushata outreach për tërheqjen e investimeve të huaja, të fokusuara në sektorët ICT/BPO dhe manifakturën e pajisjeve mjekësore.

1. Sektorin ICT/BPO

Në kuadër të fushatës outreach në sektorin ICT/BPO, AIDA, në bashkëpunim me ABSL Albania, zhvilloi një takim me përfaqësuesin e kompanisë Secitops (cfare origjine shteti), me qëllim eksplorimin e interesit për investim në Shqipëri në fushën e fintech, financës digjitale dhe shërbimeve të biznesit.

Gjatë diskutimeve, kompania prezantoi interesin për krijimin e një platforme digjitale dhe hapjen e një banke online, të fokusuar në transfertat ndërkombëtare të parave dhe ofrimin e shërbimeve financiare për sektorin ICT dhe outsourcing, duke e konsideruar Shqipërinë si një treg potencial për zgjerim të operacioneve të saj.

Gjatë takimit, AIDA prezantoi potencialin e Shqipërisë si destinacion konkurrues për investime në ICT/BPO, duke vënë në pah fuqinë punëtore të kualifikuar, kostot konkurruese, si dhe pozicionin strategjik të vendit në raport me tregjet e Bashkimit Evropian. Në vijim, AIDA do të mbajë komunikim të vazhdueshëm me kompaninë dhe do të koordinohet me institucionet përkatëse financiare dhe rregullatore për të vlerësuar më tej realizueshmërinë dhe hapat konkretë për zhvillimin e këtij projekti në Shqipëri.

2. Manifaktura e pajisjeve mjekësore

Fushata e dytë, me fokus manifakturën e pajisjeve mjekësore, u organizua me mbështetjen e Regional Cooperation Council (RCC) dhe u zhvillua në Düsseldorf, më 16–17 nëntor 2025, në kuadër të panairit ndërkombëtar MEDICA/COMPAMED 2025.

Pjesëmarrja në këtë panair krijoi mundësinë të ndërveprojmë drejtpërdrejt me kompani të fushës, të prezantojmë potencialin e Shqipërisë dhe të forcojmë pozicionimin tonë si destinacion i favorshëm për investime në këtë industri në rritje. Gjatë dy ditëve të takimit, u zhvilluan rreth 15 takime.

Gjatë takimeve, u vu re fakti se një numër i konsiderueshëm kompanish tashmë kanë partneritete me kompani që operojnë në Shqipëri, çka paraqet një mundësi reale për të çuar më tej marrëdhëniet ekzistuese dhe për të ndërtuar bazën për investime të reja direkte.

Në të dyja ditët e fushatës, AIDA pati mundësinë të përçojë një mesazh të qartë dhe të strukturuar mbi përparësitë që ofron vendi ynë për investitorët e huaj: stabilitetin makroekonomik, një klimë të favorshme biznesi, kostot konkurruese, akses të shpejtë drejt tregjeve të BE-së dhe rajonit, si dhe përqendrimin në zhvillimin e sektorëve me vlerë të shtuar.

Fushata outreach u përmyll me sukses, duke konsoliduar kontakte të rëndësishme dhe duke rritur interesin për Shqipërinë si një destinacion konkurrues për investime në sektorin e prodhimit të pajisjeve mjekësore. AIDA nisi një proces të strukturuar folloë-up-i me të gjitha kompanitë e takuara. Gjatë muajit dhjetor u organizuan dy takime online me kompanitë Barkeley Health dhe Moslab.

Aktiviteti 1.1.1.3 Mirëmbajtja e CRM

Në kuadër të përmirësimit të proceseve të brendshme dhe menaxhimit të marrëdhënieve me investitorët, është parashikuar implementimi i një sistemi CRM (Customer Relationship

Management), i cili do të mundësojë menaxhimin dhe analizën e ndërveprimeve dhe të të dhënave të klientëve, me synim rritjen e cilësisë së shërbimeve të ofruara nga dhe nëpërmjet AIDA.

Aktualisht, ky komponent nuk është implementuar.

Indikatorët

Masa	Treguesit e parashikuar (për periudhën 2021-2027)	Realizimi 2025
Promovimi/lehtësimi sistematik i investimeve të synuara	- 7 fushata specifike të targetimit për grupet e synuara (1 për cdo vit) - 51 projekte tërheqëse të investimeve - 127,500 mijë euro volumi i investimeve - krijimi i 15,300 vende pune të reja	2 fushata specifike të targetimit; NA NA NA

1.1.2 Masa “Program i strukturuar për shërbimin e përkujdesjes së mëtejshme”

Institucioni udhëheqës: Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA)

Institucione kontribues:

- Ministria përgjegjëse për ekonominë,
- Bashkitë,
- Dhomat dhe shoqatat e tregtisë.

Aktiviteti 1.1.2.1: Intensifikimi i masave të “after-care” bazuar në një qasje të strukturuar

Shërbimi “Aftercare”

Gjatë vitit 2025, Sektori Lead & Aftercare pranë Drejtorisë së Investimeve të Huaja, Partneritetit dhe Kërkimit në AIDA organizoi **1 fushatë** të shërbimit të përkujdesjes ndaj investitorit, dhe **1 tryezë të rrumbullakët** me kompani të sektorit të ICT-BPO dhe teknologjisë së informacionit dhe ndërmori nismën “*Investor Support Days*”. Rrjeti i bashkëpunimit me qeverisjen lokale funksionon aktualisht me 12 bashki të vendit, përkatësisht Shkodër, Vlorë, Tiranë, Durrës, Berat, Lezhë, Fier, Elbasan, Kavajë, Vorë, Kamëz dhe bashkinë Korçë.

Në kuadër të zhvillimit të forumit më të madh të investimeve Match-Maker Albania, i cili u mbajt për herë të parë në muajin Mars, u realizuan 29 takime me subjekte të huaj dhe vendas, duke i asistuar gjatë eventit me ndërlihdje kontaktesh dhe bashkëpunimesh me palët relevante, kompani, institucione shtetërore, ambasada, agjenci homologe investimesh etj.

Në muajt Prill–Maj u zhvillua fushata Aftercare me kompani të sektorit ICT-BPO, në bashkëpunim me Shoqatën ABSL Albania, gjatë së cilës u realizuan takime me 11 kompani. Në këtë kuadër u organizua gjithashtu Tryeza e Rrumbullakët e Sektorit ICT-BPO, me pjesëmarrjen e 18 kompanive nga sektori.

Me bashkëpunimin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, AIDA finalizoi me sukses nismën “*Investor Support Days*”. Kjo iniciativë u zhvillua përmes takimeve javore me kompanitë zvicerane, britanike dhe amerikane. AIDA pati përfaqësinë e institucioneve si Ministria e

Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, etj. Gjithashtu ambasadat e Zvicrës, Mbretërisë së Bashkuar si dhe SËISSA-s, Dhomës Britanike të Tregtisë dhe AmCham.

Në këto tryeza morën pjesë një total prej 54 kompanish. Në vijim të problematikave të raportuara janë dërguar dhe po ndiqen me prioritet shkresat dhe korrespondenca elektronike me institucionet e qeverisjes qendrore për kompanitë.

Në total, përgjatë vitit 2025, AIDA ka takuar 112 kompani përmes vizitave në terren, tryezave të rrumbullakëta, si edhe përmes iniciativave të tjera të ndërmarra në kuadër të angazhimit të saj me kompanitë e huaja dhe vendase.

Aktiviteti 1.1.2.1: Zgjerimi i portofolit të shërbimeve duke gjeneruar sinergji me veprime të tjera prioritare (p.sh. zhvillimi i aftësive, promovimi i lidhjeve, zhvillimi i furnitorëve)

Memorandume të nënshkruara

AIDA - ABSL

Në janar 2025, AIDA nënshkroi Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Association of Business Service Leaders (ABSL Albania), me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit dhe informimit mbi sektorët BPO, ITO, SSC dhe R&D në Shqipëri. Marrëveshja synon realizimin e aktiviteteve me karakter edukativ, përfshirë trajnime, ëorkshope dhe ëebinare, si dhe organizimin e tryezave të përbashkëta me aktorët kryesorë të sektorit, me qëllim identifikimin e problematikave dhe nevojave të tregut. Gjithashtu, palët parashikojnë shkëmbimin periodik të statistikave mbi zbatueshmërinë dhe aktivitetin e këtyre sektorëve në Shqipëri, shpërndarjen reciproke të kërkesave për bashkëpunim me kompani, organizata dhe institucione vendase ose të huaja, si dhe shkëmbimin e informacionit lidhur me organizimin e panairove, ekspozitave dhe konferencave me karakter kombëtar ose ndërkombëtar.

AIDA – MÛSIAD ALBANIA

Në shkurt 2025, AIDA nënshkroi Marrëveshjen e Bashkëpunimit me MÛSIAD Albania, me qëllim sigurimin e shkëmbimit të rregullt të informacionit mbi ekonominë dhe investimet, si dhe ofrimin e asistencës në zbatimin e projekteve bashkëpunuese. Marrëveshja parashikon shkëmbimin e të dhënave ekonomike dhe statistikore, shënimeve, raporteve vjetore dhe botimeve periodike në interes të të dy palëve, si dhe shpërndarjen reciproke të informacionit mbi kompanitë turke dhe shqiptare nëpërmjet krijimit dhe përdorimit të databazave të përbashkëta. Palët mbështesin njëra-tjetrën në organizimin dhe realizimin e delegacioneve dhe misionëve të biznesit, informojnë reciprokisht mbi organizimin e ekspozitave dhe panairove tregtare me karakter kombëtar ose ndërkombëtar, si dhe inkurajojnë zhvillimin e turizmit ndërmjet vendeve, duke kontribuar në organizimin e programeve tregtare dhe turistike.

AIDA - INVEST NORTH MACEDONIA

Në kuadër të Matchmaker Albania 2025, në muajin mars, AIDA nënshkroi Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Agency for Foreign Investments and Export Promotion of the Republic of North Macedonia (Invest North Macedonia), me qëllim sigurimin e shkëmbimit të informacionit ekonomik dhe tregtar, promovimin e bizneseve me përfitim të ndërsjellë, krijimin e marrëdhënieve ndërmjet organizatave të biznesit dhe zgjerimin e bashkëpunimit të tyre me përfshirjen e dhomave të tjera të tregtisë. Marrëveshja synon gjithashtu informimin mbi panaire, ekspozita dhe takime biznesi me fokus zhvillimin ekonomik, si dhe ndërmarrjen e veprimeve për shkëmbimin e ndërsjellë të përvojave, forcimin e mirëkuptimit të ndërsjellë dhe rritjen e ndërgjegjësimit të komunitetit të biznesit për përmirësimin e mjedisit të biznesit.

AIDA - RAS

Në kuadër të Matchmaker Albania 2025, në muajin mars, AIDA nënshkroi një Marrëveshje Bashkëpunimi me Development Agency of Serbia (RAS), me qëllim sigurimin e shkëmbimit të informacionit ekonomik dhe tregtar, promovimin e bizneseve me përfitim të ndërsjellë, krijimin e marrëdhënieve ndërmjet organizatave të biznesit dhe zgjerimin e bashkëpunimit të tyre me përfshirjen e dhomave të tjera të tregtisë. Marrëveshja synon gjithashtu informimin mbi panaire, ekspozita dhe takime biznesi me fokus zhvillimin ekonomik, si dhe shkëmbimin e përvojave, forcimin e mirëkuptimit të ndërsjellë dhe rritjen e ndërgjegjësimit të komunitetit të biznesit për përmirësimin e mjedisit të biznesit.

AIDA - BCCA

Në kuadër të Matchmaker Albania 2025, në muajin mars, AIDA nënshkroi Marrëveshjen e Bashkëpunimit me The United Kingdom of Great Britain and Northern Ireland Chamber of Commerce in Albania (BCCA), me qëllim sigurimin e shkëmbimit të informacionit ekonomik dhe tregtar, promovimin e bizneseve me përfitim të ndërsjellë, krijimin dhe zgjerimin e marrëdhënieve ndërmjet organizatave të biznesit, informimin mbi panaire, ekspozita dhe takime biznesi me fokus zhvillimin ekonomik, si dhe ndërmarrjen e veprimeve për shkëmbimin e përvojave dhe ndërgjegjësimin e komunitetit të biznesit për përmirësimin e klimës së biznesit.

AIDA – KAZAKH INVEST

Në kuadër të Matchmaker Albania 2025, në muajin mars, AIDA nënshkroi Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Kazakh Invest, me qëllim tërheqjen e kompanive kazakistane dhe shqiptare të interesuara për zhvillimin e biznesit përmes investimeve të huaja, sigurimin e informacionit publik mbi projektet e investimeve në Shqipëri dhe Kazakistan, si dhe organizimin dhe pjesëmarrjen në aktivitete dhe ngjarje ndërkombëtare me interes të ndërsjellë për të dy palët.

AIDA - DPT

AIDA nënshkroi Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, me qëllim shkëmbimin e informacionit dhe të dhënave statistikore mbi punësimin dhe subjektet me status strategjik, si dhe organizimin e takimeve të përbashkëta për koordinim institucional dhe forcimin e bashkëpunimit ndër-institucional.

AIDA - FIPA

Në kuadër të forumit EB6 – EU, në muajin tetor, AIDA nënshkroi Memorandumin e Mirëkuptimit me Agjencinë e Promovimit të Investimeve në Bosnjë dhe Hercegovinë (FIPA), duke shënuar një hap të ri për forcimin e bashkëpunimit rajonal. Marrëveshja synon fuqizimin e bashkëpunimit institucional ndërmjet dy agjencive dhe nxitjen e iniciativave të përbashkëta që mundësojnë realizimin e projekteve dhe ideve të reja të investimeve në rajon.

AIDA – SIMEST S.P.A

Në kuadër të mbledhjes së parë ndërqeveritare midis Italisë dhe Shqipërisë, në muajin nëntor, AIDA nënshkroi Memorandumin e Mirëkuptimit me SIMEST, duke krijuar një instrument të ri për rritjen e investimeve italiane në Shqipëri. Marrëveshja synon promovimin e përbashkët të Shqipërisë si një destinacion i favorshëm për investime italiane në sektorë si energjia, turizmi, bujqësia, prodhimi dhe teknologjia. Dokumenti përcakton gjithashtu lehtësimin e bashkëpunimit mes bizneseve përmes organizimit të misioneve ekonomike, forumeve dhe eventeve të dedikuara për investitorët, shkëmbimin e informacionit ekonomik dhe tregtar për të mbështetur vendimmarrjen për investimet e huaja direkte, si dhe identifikimin e projekteve të përbashkëta strategjike, që mund të mbështeten nga instrumentet financiare të SIMEST dhe strukturat mbështetëse të AIDA-s.

AIDA - GAFI

Në kuadër të Forumit Ekonomik Shqipëri – Egjipt, në muajin dhjetor AIDA nënshkroi Memorandumin e Mirëkuptimit me Autoritetin e Përgjithshëm për Investime dhe Zonat e Lira të Republikës Arabe të Egjiptit (GAFI), me qëllim thellimin e bashkëpunimit në fushën e investimeve përmes shkëmbimit të informacionit, praktikave më të mira dhe përvojave institucionale, si dhe përmirësimin e klimës së biznesit në të dy vendet.

Forume biznesi

Gjatë vitit 2025, AIDA ka qenë organizatore / bashkëorganizatore e shumë forumeve ekonomike me qëllim forcimin e bashkëpunimit ekonomik. Në vijim janë forumet ekonomike:

Forumi i Biznesit Shqipëri–Francë

Në muajin Mars AIDA, në bashkëpunim me Ambasadën Franceze në Shqipëri, organizoi Forumin e Biznesit Shqipëri–Francë, me pjesëmarrjen e një delegacioni të nivelit të lartë nga MEDEF International, i kryesuar nga Z. Christophe Petit. Forumi shërbeu si një platformë e rëndësishme dialogu për forcimin e bashkëpunimit ekonomik dhe nxitjen e investimeve franceze në Shqipëri.

Gjatë eventit u theksua interesi i kompanive franceze për bashkëpunime dhe investime në Shqipëri, në një kontekst ku Franca renditet ndër shtatë kontribuesit kryesorë të Investimeve të Huaja Direkte në vend. Paneli i diskutimit mbledhi përfaqësues të lartë të institucioneve shqiptare dhe të sektorit të zhvillimit ekonomik, të cilët prezantuan politikat mbështetëse, projektet strategjike dhe potencialet e Shqipërisë si destinacion konkurrues për investime.

Forumi u pasua nga takime B2B mes bizneseve shqiptare dhe franceze, duke krijuar mundësi konkrete për partneritete të reja dhe bashkëpunim afatgjatë mes dy vendeve.

- **Forumi ekonomik WB6 – EU**

Më datë 13–14 tetor, në Pallatin e Kongreseve në Tiranë, u zhvillua Forumi i Investimeve EU–WB6, një ngjarje dyditore me rëndësi strategjike, e fokusuar në forcimin e bashkëpunimit ndërmjet agjencive të promovimit të investimeve të Ballkanit Perëndimor dhe në nxitjen e investimeve të huaja direkte në rajon.

Forumi mbledhi përfaqësues të nivelit të lartë nga vendet e rajonit, Bashkimi Evropian dhe institucione ndërkombëtare, duke shërbyer si një platformë për dialog, koordinim dhe shkëmbim praktikash më të mira.

Në kuadër të forumit, AIDA nënshkroi disa Deklarata të Përbashkëta Bashkëpunimi, me synimin për të forcuar marrëdhëniet ekonomike ndërrajonale dhe për të promovuar Ballkanin Perëndimor si një destinacion të unifikuar dhe konkurrues për investime.

- **Side event “IPAs connect”**

Në kuadër të Forumit Ekonomik EB6–BE, AIDA organizoi aktivitetin paralel “IPAs Connect”, i cili bashkoi përfaqësues nga gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, Bashkimi Evropian, Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC), si dhe Banka Botërore.

Në këtë aktivitet morën pjesë agjencitë e investimeve të Shqipërisë (AIDA), Bosnjë dhe Hercegovinës, Kosovës, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë, duke krijuar një platformë të strukturuar dialogu dhe bashkëpunimi ndërinstitutional.

Aktiviteti mbledhi së bashku aktorë kyç nga Ballkani Perëndimor dhe Bashkimi Evropian, duke shërbyer si një hapësirë për shkëmbimin e përvojave, praktikave më të mira dhe mundësive të investimit në rajon. Pjesëmarrja e përfaqësuesve kontribuoi në pasurimin e diskutimeve, në ndarjen e informacionit mbi tregjet kombëtare përkatëse, si dhe në forcimin e bashkëpunimit rajonal në fushën e promovimit dhe lehtësimit të investimeve.

Gjithashtu, përfaqësues nga Gjermania, Franca, Italia, Hungaria, si dhe vende të tjera evropiane, prezantuan praktika të suksesshme në promovimin e investimeve, duke theksuar potencialin e Ballkanit Perëndimor si një destinacion konkurrues dhe në rritje për investimet e huaja direkte.

- **Forumi ekonomik Shqipëri – Turqi**

Më datë 17 tetor u zhvillua Forumi më i Madh i Investimeve Shqipëri – Turqi 2025, një ngjarje e rëndësishme e organizuar nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) në bashkëpunim me MÜSIAD Albania.

Forumi shërbeu si një platformë e nivelit të lartë për të forcuar bashkëpunimin ekonomik, për të rritur shkëmbimet tregtare dhe për të identifikuar mundësi të reja investimi midis dy vendeve.

Forumi mbledhi përfaqësues të qeverive, investitorë, sipërmarrës, organizata biznesi dhe stakeholderë të rëndësishëm nga Shqipëria dhe Turqia.

Në kuadër të Forumit u zhvilluan edhe katër panele tematike, të cilat adresuan sektorët kryesorë strategjikë të zhvillimit ekonomik dhe investimeve, me tematika:

- Paneli I: “Turizmi i së Nesërme: Investime për një Destinacion Elitar”,
- Paneli II: “Zhvillimi Strategjik i Infrastrukturës dhe Ndërtimit”,
- Paneli III: “Bujqësia në Fokus: Rritja e Investimeve dhe Zhvillimi i Sektorit”, si dhe
- Paneli IV: “E Ardhmja Digjitale e Shqipërisë: Inovacioni dhe Potenciali i Investimeve”.

Panelistët ofruan diskutime të thelluara mbi mundësitë konkrete të bashkëpunimit dhe investimeve mes Shqipërisë dhe Turqisë.

Forumi i Investimeve Shqipëri–Turqi 2025 shënon hapjen e një kapitulli të ri në partneritetin strategjik midis dy vendeve dhe krijon bazat për një zhvillim të qëndrueshëm, rritje të investimeve dhe forcim të marrëdhënieve tregtare në vitet që vijnë.

• **Tirana Economic Forum**

Më 10 Dhjetor 2025, në kuadër të Tirana Economic Forum, liderë politikë, përfaqësues të biznesit dhe akademikë u mbledhën për të diskutuar sfidat dhe perspektivat e zhvillimit ekonomik të Shqipërisë dhe rajonit. Forumi shërbeu si një platformë e rëndësishme dialogu mbi politikat ekonomike, klimën e investimeve dhe bashkëpunimin rajonal.

Një nga sesionet kryesore të forumit ishte paneli “Albania’s Investment Pulse: Hoë Can Albania Attract Quality Investment”, i cili u fokusua në strategjitë për tërheqjen e investimeve cilësore dhe drejtimet strategjike të zhvillimit ekonomik të vendit.

Në këtë panel morën pjesë përfaqësues nga sektori publik, biznesi dhe institucionet financiare ndërkombëtare. Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) ishte e përfaqësuar në këtë panel, duke kontribuar në diskutimet mbi përmirësimin e klimës së investimeve, rolin e reformave, infrastrukturës dhe partneriteteve në rritjen e konkurrueshmërisë së Shqipërisë si destinacion investimesh.

• **Forumi ekonomik Shqipëri – Egjipt**

Në datat 12–14 dhjetor 2025, në Tiranë u zhvillua Forumi i Biznesit Shqipëri–Egjipt, i cili mbledhi përfaqësues të nivelit të lartë nga institucionet publike dhe komuniteti i biznesit të të dy vendeve, me qëllim forcimin e bashkëpunimit ekonomik dhe nxitjen e partneriteteve strategjike. Forumi u zhvillua me pjesëmarrjen e ministres së Ekonomisë dhe Inovacionit dhe ministres së Planifikimit, Zhvillimit Ekonomik dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Republikës Arabe të Egjiptit.

Diskutimet u fokusuan në rritjen e shkëmbimeve tregtare, nxitjen e investimeve të ndërsjella dhe zhvillimin e projekteve të përbashkëta në sektorë strategjikë si energjia, turizmi, bujqësia, teknologjia dhe punësimi. Një nga rezultatet më të rëndësishme të forumit ishte nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit midis Autoritetit të Përgjithshëm për Investime dhe Zonat e Lira të Republikës Arabe të Egjiptit (GAFI) dhe Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve

(AIDA), i cili synon thellimin e bashkëpunimit në fushën e investimeve dhe përmirësimin e klimës së biznesit.

Forumi shërbeu si një platformë kyçe për forcimin e dialogut institucional dhe ekonomik mes Shqipërisë dhe Egjiptit, duke krijuar baza të qëndrueshme për bashkëpunim afatgjatë dhe iniciativa konkrete zhvillimi.

Indikatorët

Masa	Treguesit e parashikuar (për periudhën 2021-2027)	Realizimi 2025
Program i strukturuar për shërbimin e përkujdesjes së mëtejshme	- 300 klientë të <i>after-care</i> (investitorët ekzistues) (43 klientw cdo vit) - 20 memorandume mirëkuptimi të nënshkruara me bashki/partnerë (3 MoU cdo vit) - 160 projekte të riinvestimit - 320,000 mijë EUR vëllimi i riinvestimit - 16,000 vende pune të krijuara nga investitorët ekzistues	-275 klientë të <i>after-care</i> -10 memorandume mirëkuptimi -NA -NA -NA

1.1.3 Masa “Vlerësimi dhe reforma e programit të TEDA-ve”

Institucioni udhëheqës: Ministria përgjegjëse për ekonominë

Institucione kontribues:

- Ministria përgjegjëse për ekonominë,
- Korporata Shqiptare e Investimeve.

Aktiviteti 1.1.3.1: Vlerësimi i programit TEDA dhe zhvillimi i një udhërrëfyese reformash

Viti 2025 shënoi vitin e parë të operimit të Zonës së Lirë Ekonomike, Durana Tech Park (Parku i parë teknologjik dhe shkencor në Shqipëri) dhe u konceptua qëllimisht si një fazë virtuale. Në vend që fokusi të ishte ndërtimi fizik i infrastrukturës, parku u përqendrua në ngritjen e themeleve institucionale, ligjore dhe operative, duke testuar në praktikë vlefshmërinë e modelit zhvillimor. Kjo qasje lejoi verifikimin e interesit të tregut, kapacitetit institucional dhe funksionimit të shërbimeve pa ekspozuar parkun ndaj kostove të larta kapitale në fazën fillestare. Raporti e paraqet këtë fazë si provë të suksesshme që një park teknologjik mund të funksionojë fillimisht si ekosistem, përpara se të materializohet fizikisht.

Procesi i pranimit në park u ndërtua mbi kritere të qarta, procedura standarde aplikimi dhe metodologji vlerësimi të miratuara, duke garantuar transparencë dhe besim institucional. Si rezultat, parku arriti të tërheqë mbi 50 rezidentë brenda një periudhe operative prej rreth gjashtë muajsh, duke tejkaluar ndjeshëm parashikimet fillestare të planit të zhvillimit. Ky interes i lartë konfirmon nevojën reale të tregut për një strukturë të tillë dhe vendos një bazë solide për rritje të mëtejshme në vitet në vijim.

Faza virtuale e Durana Tech Park është e parashikuar në Kreun IV të marrëveshjes midis Albanian Investment Corporation (AIC) dhe Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI), e cila është pjesë përbërëse e VKM nr. 73, datë 29.01.2025 e cila është hartuar duke ndjekur praktikat më të mira botërore, me asistencën dhe të projektit “Risi Albania”, pjesë e Programit Helvetas të financuar nga qeveria Zviceriane. Ky model është përshtatur dhe për realitetin shqiptar, dhe me asistencë të qeverisë zviceriane (projekti Risi Albania, Helvetas) si dhe qeverisë gjermane, (projekti GIZ, i cili po asiston parkun për të detajuar mënyrën e operimit e shërbimet që do të ofrojë gjatë kësaj faze fillestare të operimit.

Edhe pse në fazë virtuale, parku funksionon si një ekosistem aktiv, ku komuniteti i rezidentëve organizon takime dhe evente të përmuajshme për të nxitur njohjen, shkëmbimin e eksperiencave dhe bashkëpunimin. Faza fizike do të nisë me ndërtimin e parkut sapo të finalizohet masterplani, duke kaluar më pas në një model hibrid (virtual + fizik), sipas nevojave të rezidentëve të parkut.

Viti 2025 shënoi zgjerimin e rrjetit të partneriteteve dhe pozicionimin e Duranës në trajektoren e programeve evropiane të financimit, përmes dorëzimit të aplikimit të parë në Horizon Europe dhe ndërtimit të një pipeline-i aplikimesh për programe të tjera si Erasmus+ dhe Digital Europe. Këto hapa e vendosin parkun në një pozicion më të favorshëm për të diversifikuar burimet e të ardhurave, për të zgjeruar shërbimet me vlerë të shtuar për rezidentët dhe për të përforcuar rolin e tij si platformë ndërmjetësuese ndërmjet sektorit privat, akademisë dhe institucioneve publike.

Rezultatet e vitit 2025 dëshmojnë se Durana Tech Park e ka kaluar me sukses fazën e parë të operimit dhe ka ndërtuar një bazë të fortë për konsolidimin e mëtejshëm gjatë vitit 2026. Prioriteti kryesor për periudhën pasuese do të jetë kalimi nga faza e “aktivizimit” në një fazë “thellimi dhe strukturimi”, ku fokusi do të vendoset në: finalizimin e instrumenteve kryesore të planifikimit (masterplani dhe platforma), forcimin e mekanizmave të bashkëpunimit ndër-institucional, rritjen e portofolit të shërbimeve të parkut dhe orientimin e komunitetit të rezidentëve drejt rezultateve të matshme në inovacion, punësim dhe rritje ekonomike të bazuar në dije.

Aktiviteti 1.1.3.2: Përgatitja e një koncepti zhvillimi për një TEDA të përzgjedhur

Nisur nga interesi i rezidentëve të Durana Tech Park për të patur mundësinë dhe të prodhojnë në masë produktet e tyre inovative për t'i eksportuar më pas në tregjet ndërkombëtare, Durana po vlerëson opsionin e aplikimit për të zhvilluar një TEDA, krahas zhvillimit të infrastrukturës fizike të parkut teknologjik që pritet të fillojë së shpejti, në funksion të rezidentëve të saj. Zbatimi i konceptit të zhvillimit për një TEDA përfshin ndërtimin dhe funksionalizimin e infrastrukturës fizike, në të njëjtën zonë në afërsi të Parkut, duke qënë se Korporatës së Investimeve Shqiptare i janë transferuar rreth 62 ha tokë shtet në zonën ku do të ndërtohet Parku teknologjik.

Infrastrukturë fizike

Zbatimi parashikon krijimin e një infrastrukture të plotë dhe funksionale, e cila përfshin:

- ndërtimin e rrjeteve rrugore lidhëse me infrastrukturën kombëtare;
- sigurimin e furnizimit të qëndrueshëm me energji elektrike dhe ujë;
- zhvillimin e rrjeteve të telekomunikacionit dhe internetit me kapacitet të lartë;
- infrastrukturë logjistike dhe magazinimi;

Indikatorët

Masa	Treguesit e parashikuar (për periudhën 2021-2027)	Realizimi 2025
Vlerësimi dhe reforma e programit të TEDA-ve	- finalizimi i vlerësimit, udhëzuesit të reformës dhe konceptit të zhvillimit (deri në vitin 2022) - 30 ha tokë e zhvilluar/20 ha e përdorur nga investitorët në zonën e zgjedhur - 20 rezident aktivë në zonën e zgjedhur - 3,000 vende pune të reja të krijuara në zonën e zgjedhur	62 ha tokë që do të përdoret 50 rezidentë

1.1.4 Masa “Programi i eksporteve”

Institucioni udhëheqës: Ministria përgjegjëse për ekonominë

Institucione kontribues: Grupi i punës

Aktiviteti 1.1.4.1: Hartimi i programit të eksporteve

➤ Miratimi i Programit për Nxitjen dhe Lehtësimin e Eksporteve (Dhjetor 2025)

Nëpërmjet Urdhrit Nr.180, datë 30.12.2025, “Për Miratimin e Programit për Nxitjen dhe Lehtësimin e Eksporteve 2026-2030”, (botuar në Fletoren Zyrtare Nr.247, datë 30.12.2025), është miratuar dhe ka hyrë në fuqi zbatimi i “Programit për nxitjen dhe lehtësimin e eksporteve 2026-2030”.

➤ Progres i arritur në iniciativat rregullatore (Dhjetor 2025 / Qershor 2026) dhe/ose masat mbështetëse në lidhje me partneritetet e zinxhirit të vlerës industriale me Bashkimin Evropian (Dhjetor 2027).

Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit ka përgatitur një paketë dokumentesh, të fokusuar në industrinë e tekstilit, e cila paraqet potencial të konsiderueshëm për rritjen e eksporteve dhe integrimin në tregjet ndërkombëtare.

- “Raporti i Vlerësimit të Zinxhirit të Vlerës së Tekstilit” analizon në mënyrë të detajuar strukturën e zinxhirit të vlerës në këtë industri, identifikon aktorët kryesorë, sfidat dhe boshllëqet në konkurrueshmëri, si dhe ofron rekomandime për modernizim dhe përafrim me standardet e BE-së.
- Raporti “Zhvillimi i Masave dhe Nismave Mbështetëse” propozon instrumente fiskale dhe jofiskale—si stimuj tatimorë, grante, programe për promovimin e eksporteve dhe zhvillimin e aftësive—me qëllim rritjen e konkurrueshmërisë dhe gatishmërisë për eksport të sektorit.
- Dokumenti “Hartimi i Nismave Rregullatore dhe Rekomandimeve të Politikave” shqyrton boshllëqet ekzistuese ndërmjet kuadrit ligjor shqiptar dhe atij të BE-së dhe paraqet

rekomandime për harmonizimin me acquis-në e BE-së, përfshirë kërkesat për sigurinë e produkteve, ekodizajnin, etiketimin dhe ekonominë rrethore.

- Raporti “Forcimi i Partneriteteve të Industrisë së Tekstilit me BE-në” paraqet një plan për krijimin e partneriteteve strategjike me aktorë të industrisë në BE, duke identifikuar mundësi bashkëpunimi, modele të ndërmarrjeve të përbashkëta dhe mundësi investimi që mund të nxisin eksportet dhe bashkëpunimin ndërkombëtar.

➤ **Nxitja e eksporteve**

Platforma e Eksporteve pranë AIDA: Kjo platformë është konceptuar si një zgjidhje strategjike për të mbështetur ndërkombëtarizimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, duke përforcua misionin e AIDA-s për të ofruar shërbime me vlerë të shtuar që lidhen ngushtë me eksportin dhe rritjen e aktivitetit tregtar të sipërmarrjeve shqiptare në tregjet ndërkombëtare. Platforma është publikuar në të gjitha rrjetet sociale të AIDA-s. www.exportalbania.al

AIDA organizoi gjatë muajit qershor, “Info Day” dhe “Takime door to door” me bizneset eksportuese të qarqeve, Shkodër, Gjirokastrë, Elbasan, Durrës, Berat, (faza e parë) ku kanë bërë promovimin e platformës dhe sensibilizimin e kompanive eksportuese shqiptare për të përfutur nga shërbimet që ofron kjo platformë. dhe gjithsej në platformën B2b, janë regjistruar 155 kompani eksportuese të sektorëve të ndryshëm. Gjatë vitit 2026 do vijojë faza e dytë me informimin dhe regjistrimin e bizneseve.

Gjatë periudhës 8 dhjetor 2025 deri më 7 Janar 2026, platforma është vizituar nga 4,550 vizitorë

- **Pjesëmarrja në Panaire Ndërkombëtare 2025**

Rritja e mundësive të rrjetëzimit dhe lehtësimi i përfshirjes së kompanive shqiptare në panairët ndërkombëtare

➤ **“Biofach 2025”, datat 11-14 Shkurt 2025, Nuremberg, Gjermani**

Në këtë panair morrën pjesë 8 kompani, 6 kompani nga sektori i bimëve medicinale dhe aromatike dhe 2 kompani nga sektori i vajit të ullirit. Kompanitë realizuan 467 kontakte me kompani të huaja.

➤ **“Wine Paris”, në datat 10-12 shkurt 2025, Paris, Francë**

Në këtë panair morrën pjesë 3 kompani të sektorit të verës. Kompanitë realizuan 20 kontakte me kompani të huaja.

➤ **“Food Expo”, në datat 8-10 mars 2025, në Athinë.**

Në këtë panair morrën pjesë 6 kompani, 2 kompani nga sektori i bimëve medicinale dhe aromatike, 3 kompani nga sektori i verës dhe një kompani e kafes. Kompanitë realizuan 209 kontakte me kompani të huaja.

➤ **‘ITB Berlin’, në datat 4-6 mars 2025, Berlin, Gjermani.**

Më këtë panair, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, mori pjesë si bashkë-ekspozuese krahas Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit. ITB Berlin (Internationale Tourismus-Börse Berlin)

është panairi më i madh i turizmit në botë, i cili tërheq shumë ekspozues dhe pjesëmarrës dhe mbetet një platformë kyç për rrjetëzimin, inovacionin dhe turizmin global. Gjithashtu luan një rol jetik në formësimin e trendeve, politikave dhe partneriteteve në sektorin e turizmit. Kompanitë e përfaqësuara në panair përfshijnë hotele, struktura akomoduese, operatorë turistikë, linja ajrore etj.

➤ **“Panairi i Punës”, në datën 2 mars 2025, Athinë, Greqi.**

Në këtë datë, AIDA mori pjesë në Panairin “Puno & Jeto Aty Ku Ke Zemrën”, i cili u mbajt në Athinë, Greqi. Panairi kishte si qëllim informimin dhe ofrimin e mundësive të reja për punësim, investim dhe kthimin në Shqipëri të shqipëtareve që jetojnë dhe punojnë në Greqi, për të kontribuar në zhvillimin e vendit.

➤ **Panairi “Riga Food 2025”, në datat 04-06 shtator, në Letoni.**

Në këtë panair morrën pjesë 6 kompani, 1 kompani nga sektori i bimëve medicinale dhe aromatike, 1 kompani nga sektori i mjaltit, 1 kompani nga sektori i ullinjve dhe i vajit të ullirit, 1 kompani kompani nga sektori i luleshtrydheve, 1 kompani nga sektori ipërpunimit të domateve , dhe një ga sektori i përbërësve ushqimor. Kompanitë realizuan 199 kontakte me kompani të huaja.

➤ **Panairi “A+A 2025”, në datat 4-7 Nëntor 2025 Düsseldorf, Gjermani,**

Në këtë panair morrën pjesë 5 kompani të sektorit të rrobave të punës. Kompanitë realizuan 280 kontakte me kompani të huaja. Pjesëmarrja në Panairin Ndërkombëtar A+A 2025 hapi mundësi reale për rritjen e eksporteve dhe përfshirjen e prodhuesve shqiptarë në zinxhirët e furnizimit ndërkombëtar.

➤ **“Natural Organic Dubai 2025, në datat 17 – 19 Nëntor 2025, Dubai.**

Në këtë panair morrën pjesë 5 kompani, 1 kompani nga sektori i bimëve medicinale dhe aromatike, 1 kompani nga sektori i ullinjve dhe i vajit të ullirit, 1 kompani kompani nga sektori i lëngjeve të frurave dhe ujit, 2 kompani nga sektori i vajrave esenciale Kompanitë realizuan 199 kontakte me kompani të huaja. Kompanitë realizuan 205 kontakte me kompani të huaja.

Indikatorët

Masa	Treguesit e parashikuar (për periudhën 2021-2027)	Realizimi 2025
Programi i eksportit	Strategjia e eksportit e zhvilluar deri në vitin 2022	Miraturar

1.1.5 Masa “Iniciativa e zhvillimit të biznesit elektronik”

Institucioni udhëheqës: Ministria përgjegjëse për ekonominë

Institucione kontribues:

- Ministria përgjegjëse për ekonominë,
- Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA).

Aktiviteti 1.1.5.1: Krijimi i një faqe interneti informacioni (përfshirë udhëzuesit dhe mjetin e vetëvlerësimit për e-commerce)

Tregtia Elektronike (Ecommerce): Duke qenë se tregtia elektronike dhe biznesi elektronik janë bërë gjithnjë e më shumë të nevojshëm për strategjinë e biznesit dhe njëkohësisht një katalizator për zhvillimin ekonomik, AIDA, ka publikuar guidën mbi tregtinë elektronike për NMVM, nëpërmjet udhëzuesit “Si të nisësh një Biznes e-commerce”. Ky udhëzues përfaqëson një dokument orientues për Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme, (NMVM-të), Start-up, si edhe çdo palë të interesuar në planifikimin, dizajnin dhe zhvillimin e tregtisë elektronike. <https://aida.gov.al/e-commerce.pdf>.

Aktiviteti 1.1.5.2: Zbatimi i masave për ngritjen e kapaciteteve (programe për e-commerce)

Në kuadër të kësaj iniciative, tek fondi i zhvillimit të NMVM-ve, një nga zërat për zhvillimin e biznesit elektronik është: Krijimi i aplikacioneve apo platformave në funksion të zhvillimit të proceseve lidhur me tregtinë elektronike/e-commerce, produkteve të reja dhe/ose shërbimeve, për të përmbushur kërkesat e industrisë së tregut në vend dhe rajon për të përmirësuar biznesin, sistemet logjistike etj;

Gjatë vitit 2025, janë mbështetur gjithsej 30 biznese përkatësisht:

- Platforma dhe promovim (12)
- Digjitalizim dhe website (12)
- Aplikacione, e-commerce, marketing dhe përmirësim produkti (8)

Webinare/trajnime mbi tregtinë elektronike

Gjatë vitit 2025, janë zhvilluar takime rajonale dhe fushata ndërgjegjëse për tregtinë elektronike, të organizuara nga Drejtoria e Politikave të Nxitjes së Biznesit dhe Drejtoria e Politikave të Tregut të Brendshëm, në bashki dhe qarqe të ndryshme të vendit, si: Shkodër, Vlorë, Tiranë, Durrës, Kukës, Dibër, Fier dhe Elbasan.

Indikatorët

Masa	Treguesit e parashikuar (për periudhën 2021-2027)	Realizimi 2025
Iniciativa e zhvillimit të biznesit elektronik	- 300 biznese përfituese (43 cdo vit) - 75 zgjidhje për biznesin elektronik/tregtinë elektronike të miratuara nga përfituesit - 15% rritje në eksportet e bizneseve përfituesve	30 biznese përfituese Na Na

1.1.6 Masa “Vlerësimi i modelit të diplomacisë ekonomike”

Institucioni udhëheqës: Ministria përgjegjëse për punët e jashtme

Institucione kontribues:

- Ministria përgjegjëse për ekonominë,

- AIDA.

Aktiviteti 1.1.6.1: Vlerësimi i modelit ekzistues të diplomacisë ekonomike dhe identifikimi i opsioneve të reformës në periudhën 2025–2027.

Në kuadër të Planit të Veprimit të Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2021–2027, MEPJ ka nisur procesin e formalizimit të mekanizmit koordinues ndërinstitucional (GNIP) mbi vlerësimin e modelit ekzistues të diplomacisë ekonomike dhe identifikimin e opsioneve për reformë për periudhën 2026–2027. Qëllimi i GNIP është:

- përmirësimi i efektivitetit të diplomacisë ekonomike;
- integrimi i diplomacisë ekonomike në politikat industriale dhe tregtare;
- përfshirja e ekspertizës ndërkombëtare;
- rritja e koordinimit me institucionet kombëtare dhe sektorin privat.

Indikatorët

Masa	Treguesit e parashikuar (për periudhën 2025-2027)	Realizimi 2025
Vlerësimi i modelit të diplomacisë ekonomike	- Vlerësimi i modelit ekzistues të diplomacisë ekonomike dhe identifikimi i opsioneve të reformës në periudhën 2025- 2027.	Në proces

II. Objektivi specifik 1.2: “Zhvillimi i NMVM-ve, sipërmarrja dhe inovacioni”

1.2.1 Masa “Lidhja mes NMVM-ve dhe startup-eve”

Institucioni udhëheqës: Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) dhe Agjencia “Startup Albania”

Institucione kontribues: Ministria përgjegjëse për ekonominë

Aktiviteti 1.2.1.1: Organizimi i aktiviteteve ndërgjegjëse me startup-e dhe i bizneseve NMVM në periudhën 2025–2027.

Agjencia shtetërore “Startup Albania” ka vijuar konsolidimin e ekosistemit të startup-eve përmes një kombinimi mbështetjeje financiare dhe aktiviteteve ndërgjegjëse. Përmes Skemës së Grantit me buxhet 3 milionë euro janë mbështetur 81 startup-e në fazat e konceptit, zhvillimit dhe rritjes, ndërsa dimensionin jo-financiar është forcuar përmes 69 eventeve, 43 takimeve konsultuese, 19 lancimeve produktesh dhe angazhimit të një rrjeti prej 30 mentorësh. Në kuadër të rritjes së kapaciteteve dhe ndërveprimit me sektorë kyç, janë organizuar aktivitete të dedikuara me sektorin bankar për integrimin e startup-eve fintech, si dhe ëorkshop-e me Deloitte mbi përgatitjen financiare dhe investuese të startup-eve. Agjencia ka promovuar gjithashtu startup-et shqiptare në panairë ndërkombëtare si ITB Berlin, GITEK Berlin dhe VivaTech Paris, duke lehtësuar lidhje me investitorë dhe partnerë strategjikë. Në shtator 2025 u lançua platforma digjitale “Startup Albania”,

e cila centralizon regjistrimin, aplikimet për financim, trajnimet dhe rrjetëzimin, ndërsa gjatë vitit u prezantua edhe Raporti i parë i Ekosistemit Start-up në Shqipëri, i përgatitur nga Startup Genome, duke ofruar një analizë krahasuese ndërkombëtare të pozicionimit të vendit.

Indikatorët

Masa	Treguesit e parashikuar (për periudhën 2025-2027)	Realizimi 2025
Lidhja mes NMVM-ve dhe startup-eve	- Organizimi i aktiviteteve ndërgjegjëse me start up-e dhe bizneseve NMVM në periudhën 2025- 2027.	Agjencia “Startup Albania” ka organizuar 69 aktivitete të dedikuara startup-eve, 19 lancime produktesh, si dhe 4 sesione virtuale mentorimi dhe 1 sesion fizik mbi sigurinë kibernetike

1.2.2 Masa “Aksesi në programet e Bashkimit Evropian në fushën e biznesit”

Institucioni udhëheqës: Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) dhe Agjencia “Startup Albania”

Institucione kontribues: Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA)

➤ Pjesëmarrja e Shqipërisë në programin e Bashkimit Evropian Single Market Program (SMP) 2021-2027

Bazuar në përfshirjen e Shqipërisë në programin e Bashkimit Evropian Single Market Program (SMP) 2021-2027, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, më mbështetjen e projektit SANECA II (GIZ) ka hartuar në vitin 2025 një Guidë- Udhëzues për të informuar lidhur me aplikimet e entiteteve shqiptare për propozimet për programe dhe projekte me objektiv ndërkombëtarizimin e tyre. Qëllimi i guidës është të shërbejë si një burim informacioni për palët e interesuara në Shqipëri - veçanërisht autoritetet publike kombëtare dhe lokale, institucionet, bizneset, OJF-të, akademinë dhe profesionistët se si të aksesojnë fonde për projektet e tyre nga një numër programesh financimi të BE-së, dhe mundësi të tjera të ndryshme financimi ku Shqipëria është e kualifikuar/potencialisht e kualifikuar për të aplikuar, duke përfshirë këtu edhe programin e SMP.

Me mbështetjen e projektit Saneca II (GIZ) janë organizuar disa sesione informuese dhe seminare trajnimi për të mundësuar rritjen e informimit, ndërgjegjësimin dhe aplikimet në projekte, duke përfshirë këtu dhe thirrjet për aplikime në kuader të SMP. Në këto takime kanë marrë pjesë rreth 200 pjesëmarrës nga sektori privat, organizata biznesi, academia, profesionistë dhe palë të tjera të interesuara (qershor dhe tetor 2025).

➤ Promovimi i Shqipërisë si një ekosistem fillestar dhe inovacioni nëpërmjet Projekti EEN 2022-2025

Projekti Enterprise Europe Netëork (EEN Albania) 2022–2025 (Marrëveshja e Grantit nr. 101075194) është pjesë e Single Market Programme (SMP COSME), i financuar nga European

Innovation Council and SMEs Executive Agency (EISMEA). Projekti synon rritjen e konkurrueshmërisë, kapaciteteve inovative dhe potencialit të ndërkombëtarizimit të NVM-ve shqiptare, përmes shërbimeve të personalizuarra këshillimore dhe lehtësimit të partneriteteve të biznesit.

AIDA (Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve) vepron si Koordinator e konsorciumit, i cili përbëhet nga partnerët e mëposhtëm:

- AIDA – Koordinator
- RDA Tirana (Agjencia Rajonale e Zhvillimit)
- Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Durrës (CCIDR)
- Qendra për Promovimin e Konkurrueshmërisë (CCP)
- Dhoma Ekonomike e Gruas Shqipëri (ËECA)

Arritjet kryesore dhe të dhënat e monitorimit (16.12.2024 – 30.06.2025)

Platforma e raportimit të EEN (sistemi online i EISMEA / NEXTeen) gjurmon automatikisht të gjithë indikatorët dhe rezultatet. Më poshtë paraqiten shifrat e verifikuara nga sistemi:

- Arritje totale: 320 SME të suportuara
(Tejkalim i pritshmërive pavarësisht afatit të shkurtër të zbatimit)
- Arritje këshillimore: 293 / 30
(138.4% e objektivit të arritur) (Përfshin këshillime 1-me-1, matchmaking dhe ditë informuese)
- Arritje partneriteti: 27 / 30
(Të gjitha të lidhura me bashkëpunime biznesi – PA Business)
- Arritje për klient unik: 0.79
(Mbi mesataren e EEN – 0.33)
- Mbulimi sektorial: Agroushqim (50%), Turizëm (25%), Industri Krijuese (16.7%), Ndërtim (8.3%)

Këto rezultate janë arritur brenda një periudhe 6-mujore, ndërkohë që projekti ishte planifikuar për një afat 3-vjeçar. Transformimi digjital dhe aktivitetet e trajnimit për NVM-të (Prill – Qershor 2025)

Në kuadër të veprimeve këshillimore dhe të ngritjes së kapaciteteve të EEN Albania, AIDA zbatoi module të fokusuarra trajnimi në fushën e digjitalizimit dhe të drejtave të pronësisë intelektuale.

Rezultatet kryesore përfshijnë:

- 19 NVM përfituan nga sesione këshillimi 1-me-1 mbi strategjitë e transformimit digjital, adoptimin e tregtisë elektronike dhe mbrojtjen e IP-së;
- 42 pjesëmarrës morën pjesë në ëbinare online mbi marketingun digjital, gatishmërinë për eksport dhe aksesin në platformat e BE-së;
- 44 NVM u përfshinë në trajnime fizike në grup, të fokusuarra në mjetet digjitale, qëndrueshmërinë dhe gatishmërinë për inovacion.

Këto aktivitete mbështetën NVM-të në adoptimin e zgjidhjeve digjitale, rritjen e konkurrueshmërisë dhe përafrimin me standardet e tregut të BE-së.

Në vitin 2025, Agjencia ka nisur implementimin e projektit INTERREG IPA “NET4GREEN” (2025–2027), i fokusuar në mbështetjen e sipërmarrjeve të gjelbra, nxitjes së grave sipërmarrëse dhe certifikimin e inkubatorëve, duke forcuar kapacitetet e ekosistemit dhe duke nxitur integrimin e startup-eve shqiptare në programet dhe standardet e Bashkimit Evropian. Agjencia ka organizuar aktivitete të dedikuara rolit të integritit evropian në rritjen e inovacionit, standardizimit dhe zhvillimit të tregut. Qëllimi i këtyre aktiviteteve është rëndësia e forcimit të dialogut, aktivizimit dhe ndergjegjesimit për rolin kritik që ka harmonizimi i BE-se, duke mos e trajtuar thjesht si një perputhje teknike.

Indikatorët

Masa	Treguesit e parashikuar (për periudhën 2021-2027)	Realizimi 2025
Akresi në programet e Bashkimit Evropian në fushën e biznesit	Mbështetje për NMVM-të dhe bizneset startup për të marrë pjesë në programet e BE-së (Programin e Tregut të Përbashkët 2021- 2027)	105 Përfitues (subjekte dhe individë që kanë rritur kapacitetet e tyre përmes formave të ndryshme të asistencës)

1.2.3 Masa “Integrimi ndërkombëtar i ekosistemit të startup eve”

➤ Aktiviteti 1.2.3.1 Rritja e nismës së mentorimit nga diaspora (përfshirë aktivitetet (virtuale) të rrjetëzimit / prezantimit të ideve)

Përveç mbështetjes financiare, Agjencia Startup Albania ka zbatuar një paketë të gjerë masash jo-financiare, ku diaspora ka luajtur një rol të rëndësishëm, përmes angazhimit të ekspertëve dhe profesionistëve shqiptarë që jetojnë dhe veprojnë jashtë vendit. Krahas këtyre nismave, pjesëmarrja në panairë dhe konferenca ndërkombëtare si ITB Berlin, VivaTech dhe GITEX ka shërbyer si një mundësi konkrete për takime të drejtpërdrejta me anëtarë të komunitetit shqiptar të diasporës, duke mundësuar dialog, shkëmbim idesh dhe identifikim të hapësirave për bashkëpunim dhe angazhim të mëtejshëm në të ardhmen.

Programi i mentorëve, i cili kontribuon në rritjen e kapaciteteve të startup-eve shqiptare përmes ekspertizave të specializuara përfshin 30 profesionistë nga diaspora. Gjatë vitit 2025, janë zhvilluar 4 sesione të hapura mbi netëworking, branding personal dhe përdorimin e të dhënave gjatë vitit 2025, si edhe një aktivitet fizik tematik mbi sigurinë kibernetike dhe inteligjencën artificiale, me fokus në adresimin e rreziqeve të reja teknologjike.

Në vijim, Agjencia Startup Albania synon të zgjerojë rrjetin e mentorëve nga diaspora, të rrisë numrin e aplikimeve përmes fushatave të informimit dhe të forcojë angazhimin përmes sesioneve virtuale dhe fizike. Një objektivi tjetër i rëndësishëm është nxitja e themeluesve të suksesshëm nga diaspora që të angazhohen si investitorë në startup-e shqiptare, veçanërisht në ato iniciativa ku identifikohet potencial i lartë për rritje, inovacion dhe shkallëzim, duke kontribuar jo vetëm me kapital financiar, por edhe me ekspertizë, rrjete profesionale dhe përvojë ndërkombëtare.

➤ **Aktiviteti 1.2.3.2: Hartimi dhe zbatimi i një nisme rajonale për startup-et**

Në kuadër të programeve dhe nismave ekzistuese, nëpërmjet Skemës së Mbështetjes me Grante për Startup-e (Grant 2024–2025), Startup Albania mbështet startup-et përmes një skeme granti prej 3 milionë euro në vit. Bazuar në të dhënat për periudhën 2024–2025, janë regjistruar 38 aplikime nga anëtarë të diasporës shqiptare, duke reflektuar interesin në rritje të komuniteteve shqiptare jashtë vendit për investim dhe angazhim në iniciativa inovative në Shqipëri. Gjatë dy viteve të fundit janë financuar 15 themelues nga diaspora, të cilët kanë themeluar kompani në Shqipëri.

Indikatorët

Masa	Treguesit e parashikuar (për periudhën 2025-2027)	Realizimi 2025
Integrimi ndërkombëtar i ekosistemit të <i>startup</i> -eve	- 30 biznese <i>startup</i> shqiptare dhe 25 mentorë të diasporës që marrin pjesë - 12 organizata mbështetëse shqiptare që bashkëpunojnë me qendrat ndërkombëtare - 25 biznese <i>startup</i> shqiptare që bashkëpunojnë me qendrat ndërkombëtare	Realizuar: Janë angazhuar 30 profesionistë/mentorë nga diaspora në programin e mentorimit. Janë financuar 15 themelues nga diaspora që kanë hapur kompani në Shqipëri. Në progres: Është realizuar pjesëmarrja në 3 platforma ndërkombëtare (ITB Berlin, VivaTech dhe GITEK) për rrjetëzim dhe dialog me komunitetin e diasporës. Realizuar: Përmes Grantit 2024-2025, janë regjistruar 38 aplikime nga diaspora. Janë zhvilluar 4 sesione networking/branding dhe 1 aktivitet tematik mbi Sigurinë Kibernetike dhe AI për rritjen e kapaciteteve të startup-eve.

1.2.4 Masa “Nisma për përmirësimin e zinxhirit të vlerës së bazuar në konkurrencë”

Institucioni udhëheqës: Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit

Institucion kontribues:

- AIDA,
- Ministria përgjegjëse për ekonominë,
- MA,
- Organizata të tjera mbështetëse.

Aktiviteti 1.2.4.1: Grante për 20 konsorciume të përzgjedhura për të zhvilluar koncepte përmirësimi dhe Aktiviteti 1.2.4.2: Grante për 10 konsorciume të përzgjedhura për zbatimin e koncepteve të tyre të përmirësimit"

Në zbatim të Ligjit Nr. 80, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe të Vendimit Nr.607, datë 31.08.2016 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI)”, AKKSHI si institucion që ka në fokus zhvillimin e shkencës dhe teknologjisë në përputhje me prioritet kombëtare, duke bashkëpunuar me të gjithë institucionet dhe sektorët e linjës, kontribuon në krijimin e infrastrukturës dhe instrumenteve të përshtatshme që zbatojnë politikat e kërkimit dhe zhvillimit në Shqipëri, duke promovuar aktivitete dhe sipërmarrje që zhvillojnë shkencën, teknologjinë dhe inovacionin dhe duke luajtur një rol lider në krijimin e kulturës së kërkimit shkencor. Një nga programet e financimit të AKKSHI është edhe programi për financimin e projekteve të teknologjisë dhe inovacionit (PTI). Ky program u mundësua nga AKKSHI për herë të parë në vitin 2023.

Programi i dedikohet financimit të projekteve që vijnë si bashkëpunim mes universiteteve dhe biznesit. Nëpërmjet këtij programi universiteteve dhe institucioneve kërkimore i jepet mundësia të aplikojnë nëpërmjet thirrjes së publikuar në faqen e AKKSHI. Afati për kohëzgjatjen e aplikimit përcaktohet në thirrje. Projekt propozimet e paraqitura vlerësohen nga komisionet e vlerësimit të gjashtë fushave prioritare të kërkimit shkencor në vend. Në përfundim të këtij procesi, financohen projektet fituese me vendim të Bordit të Administrimit të AKKSHI. Gjatë vitit 2025 AKKSHI ka financuar 14 projekte PTI.

Indikatorët

Masa	Treguesit e parashikuar (për periudhën 2021-2027)	Realizimi 2025
Nisma për përmirësimin e zinxhirit të vlerës së bazuar në konkurrencë	- 40 aplikime/20 konsorciume të zgjedhura për fazën e konceptit më 2022 - 10 konsorciume të mbështetura në fazën e zbatimit 2023-2024 - 15% rritje në të ardhurat e NMVM-ve pjesëmarrëse në vitet 2023 dhe 2027 - 50 vende të reja pune të krijuara nga përfituesit deri në 2023 dhe 2027	AKKSHI nëpërmjet programit të financimit: “Projekte të Teknologjisë dhe Inovacionit”(PTI), dedikuar financimit të projekteve që vijnë si bashkëpunim mes universiteteve dhe biznesit. që synojnë zhvillimin e një produkti, procesi apo shërbimi të ri inovativ, mbështet bashkëpunimin e biznesit me komunitetin e kërkimit shkencor në vend. Gjatë vitit 2025 AKKSHI ka financuar 14 projekte PTI.

1.2.5 Masa “Rritje e aksesit në financë për NMVM-të”

AIDA për vitin 2025, menaxhoi Fondin “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme” i cili synon rritjen e konkurrueshmërisë së ndërmarrjeve, zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve, rinovimin e teknologjisë, zhvillimin e artizanatit si dhe mbështetjen e grave sipërmarrëse me qëllim nxitjen drejt eksportit dhe forcimin e aftësive të tyre lidhur me shërbimet dhe produktet për një treg të qëndrueshëm.

Vlera totale e këtij fondi e vënë në dispozicion për NVM-të ka qenë në masën 131,830,000 lekë.

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve ka publikuar në faqen e saj zyrtare, thirrjen për “Mbështetje për Zhvillim Ekonomik” të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme”, për vitin 2025.

Thirrja për aplikime qëndroi e hapur për 30 ditë kalendarike, nga data 30 janar 2025 deri me datë 28 shkurt 2025. Gjithsej aplikuan 443 subjekte.

Sesionet informuese:

AIDA për të qënë sa më pranë biznesit edhe subjekteve që nuk janë familjarë me metodat digjitale të komunikimit, AIDA, zhvilloi 5 sesione informuese mbi thirrjen, të parashikuara për t’u zhvilluar në qarqet kryesore: Tiranë, Durrës, Fier-Vlorë, Lezhë-Shkodër, Pogradec-Korçë.

1. Skema e mbështetjes financiare për zërin shpenzimet korente, mbulon kostot e mëposhtme:

- Certifikim i standardeve të prodhimit/shërbimit (përfshirë konsulencën përkatëse në fazën përgatitore);
- Përmirësim i produktit përmes etiketimit, ambalazhimit;
- Trajnime të stafit të ndërmarrjes për rritje kapacitetesh në fusha të tilla si: menaxhimi i teknologjive digjitale/inovatore, rrjetet e prokurimit, shërbime marketingu, zhvillimin dhe modernizimin e infrastrukturës së biznesit, sisteme të reja logjistike softëerike apo pajisje të reja, etj, dhe pajisje me certifikatat përkatëse nga subjekte të licencuara për trajnime;
- Pjesëmarrje në panairë ndërkombëtare me stenda të gatshme të ndërtuara nga panairi;
- Krijimi i aplikacioneve apo platformave në funksion të zhvillimit të proceseve lidhur me tregtinë elektronike/e-commerce, produkteve të reja dhe/ose shërbimeve, për të përmbushur kërkesat e industrisë së tregut në vend dhe rajon për të përmirësuar biznesin, sistemet logjistike etj;
- Përgatitja e materialeve promovuese si: banera, fletëpalosje, katalogë, broshura për përmirësim të imazhit të NMVM-ve (jo më shumë se 20% e kostos totale të projektit).

2. Skema e mbështetjes financiare për zërin shpenzimet kapitale, mbulon kostot e mëposhtme:

Projekti për Konkurrueshmërinë

- blerjen e makinerive që ndikojnë në rritjen e prodhimit dhe të përmirësimit të cilësisë së produktit.

Projekti për Mbështetjen e Artizanatit

- *blerjen e makinerive tradicionale dhe/ose teknologjike për të përmirësuar kushtet e punës për biznesin;*
- *blerjen e aplikacioneve dhe/ose programeve E-commerce*

Tabela e fondeve të disbursuara për vitin 2025.

Fondet e AIDAs 2025	Buxheti i Alokuar për 2025, në lekë	Numri i aplikimeve	Numri i kompanive përfituese	Buxheti i disbursuar në lekë
Skema 1	100,000,000	249	56	100,000,000
Fondi i Konkurrueshmërisë	21,830,000+873,333	174	19	22,703,166
Fondi i Ekonomisë Kreative (Artizanati)	10,000,000	20	10	9,126,667
Totali	131,830,000	443	85	131,829,833

Total subjekte fituese: 85

Ndarja sipas gjinisë

- **Femra:** 37 subjekte (44%)
- **Meshkuj:** 48 subjekte (56%)

Indikatorët

Masa	Treguesit e parashikuar (për periudhën 2021-2027)	Realizimi 2025
Rritja e aksesit në financë për NMVM-të	- 60 përfitues të Fondit të Zhvillimit të NMVM-ve çdo vit (2022-2027) - 30% përfitues e sipërmarrëse gra/biznese të drejtuara nga gratë (2022-2027) - 180 vende pune të reja të krijuara nga përfituesit e Fondit çdo vit (2022-2027) - hartuar një kornizë ligjore dhe nënligjore për NMVM-të (deri më 2021) - VKM për skemën e garancisë shtetërore e hartuar (deri në vitin 2023) - hartuar korniza ligjore për financimin e investimeve <i>croëdfunding</i> - krijimi i një rrjeti të engjëjve të biznesit	Gjatë vitit 2025 kanë përfituar gjithsej 85 subjekte nga skemat e AIDA-s (Skema 1, Fondi i Konkurrueshmërisë dhe Fondi i Ekonomisë Kreative). Përqindja e grave sipërmarrëse përfituese është 44% (37 subjekte nga 85 gjithsej), duke tejkaluar objektivin prej 30%. Fondi prej 131,829,833 lekësh është disbursuar plotësisht për

		85 kompani. Ndikimi në punësim pritët të raportohet pas fazës së monitorimit në terren të investimeve kapitale (makinerive).
--	--	--

1.2.6 Masa “Program për aftësitë sipërmarrëse për NMVM-të”

Institucioni udhëheqës: Agjencia Shqiptare Zhvillimit të Investimeve (AIDA)

Institucion kontribues:

- Ministria përgjegjëse për ekonominë,
- Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive,
- Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë,
- Shoqatat e biznesit.

Aktiviteti 1.2.6.1: Koordinimi i programit të aftësive sipërmarrëse për NMVM-të

AIDA në kuadër të zbatimit të projektit EEN 2025, gjatë periudhës mars–qershor 2025 janë realizuar 12 aktivitete gjithsej, duke përfshirë 6 webinarë, 3 workshope, 3 trajnime në grup si dhe sesione individuale këshillimi, të zhvilluara me SME nga sektorë të ndryshëm. Aktivitetet janë fokusuar në tema kyçe si akses në financa, planifikim dhe menaxhim financiar, përgatitje për investime, instrumente financiare, si dhe përputhshmëri fiskale dhe tatimore (Ligji nr. 87/2019 për fiskalizimin, Ligji nr. 92/2014 për TVSH-në, Ligji nr. 29/2023 për tatimin mbi të ardhurat), ligji nr. 87/2019 “Për Fiskalizimin” Faturimi elektronik dhe raportimi në kohë reale

Një pjesë e rëndësishme e trajnimeve ka trajtuar marketingun digjital (SEO, rrjete sociale, Google Ads, e-commerce, analytics), mbrojtjen e të dhënave, si eksportet dhe ndërkombëtarizimi, Eksporti i produkteve dhe shërbimeve, strategji për hyrje në tregje ndërkombëtare, eksporti i shërbimeve profesionale dhe digjitale duke kombinuar njohuri teorike me aplikim praktik dhe coaching, me synim rritjen e kapaciteteve, konkurrueshmërisë dhe përputhshmërisë ligjore të SME-ve.

Trajnimet, Webinarët, Workshop sesionet individuale janë kryer nga 3 eksperte të kontraktuar nga AIDA dhe Financuar nga Projekti i EEN 2022-2025 si vijon:

Nr. i kompanive	Lloji i sesionit të zhvilluar
14	Sesione one-to-one
82	webinare / workshop
39	Trajnime grupore me prezencë
135	Numri total i kompanive të mbështetura

Projekti SCORE Programme i Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) synon të mbështesë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në përmirësimin e kushteve të punës, rritjen e produktivitetit

dhe zhvillimin e praktikave të qëndrueshme të prodhimit. Programi kombinon trajnime praktike dhe konsulencë në kompani për të përmirësuar menaxhimin, efikasitetin dhe bashkëpunimin në vendin e punës. Në Shqipëri, projekti është zbatuar në sektorin tekstil, veshje, lëkurë dhe këpucë me mbështetjen e qeverisë suedeze dhe partnerëve lokalë. Në vitin 2025 nëntë kompani me rreth 741 punonjës morën pjesë në program, duke arritur rritje të produktivitetit dhe përmirësim të kushteve të punës. Rezultatet tregojnë rritje të produktivitetit, ulje të defekteve dhe përmirësim të sigurisë dhe angazhimit të punonjësve.

Aktiviteti 1.2.6.2: Zbatimi i trajnimeve për NMVM-të

Gjatë vitit 2025 AIDA ka realizuar trajnimet e mëposhtme:

- Trajmin i organizuar nga AIDA në bashkëpunim me Damiani&Partners dhe GIZ Albania në datat 3-4-5 Shkurt 2025.

Temat e trajnimeve:

1. Kërkim dhe analizë tregu
2. Gadishmëria për eksport
3. B2b Matchmaking

Me kompanitë e sektorëve të ushqimit, bimëve medicinale dhe aromatike, veshje dhe lëkurë, këpucë, dhe përpunim druri

- Trajnim i organizuar nga AIDA në bashkëpunim me Damiani&Partners dhe GIZ Albania në datën 3 Korrik 2025.

Tema e trajnimit: “Gatishmëria për Eksport”

Me kompanitë e sektorëve agropërpunim, Pije dhe Ushqim, Druri dhe Produkte prej Druri.

Gjithsej 60 biznese pjesëmarrëse në trajnime.

Indikatorët

Masa	Treguesit e parashikuar (për periudhën 2021-2027)	Realizimi 2025
Program për aftësitë sipërmarrëse për NMVM-të	- 12 trajnime çdo vit. - 300 pjesëmarrës në trajnime çdo vit.	Janë zhvilluar trajnime intensive 3-ditore (shkurt 2025) dhe sesione specifike (korrik 2025) në bashkëpunim me partnerët Damiani & Partners dhe GIZ Albania. Gjithsej 60 biznese

		pjesëmarrëse nga sektorët strategjikë: ushqimi, bimët medicinale/aromatike, veshje/këpucë, përpunim druri dhe agropërpunim.
--	--	---

III. Objektivi specifik 1.3: Zhvillimi i kapitalit njerëzor

1.3.1 Masa “Skema e mbështetjes për zhvillimin e kapitalit njerëzor bashkëpunues”

Institucioni udhëheqës: Agjencia Shqiptare e Investimeve e Investimeve (AIDA)

Institucion kontribues:

- Ministria përgjegjëse për ekonominë,
- MA,
- AKKSHI.

Aktiviteti 1.3.1.1: Ofrimi i subvencioneve për NMVM-të (pagat) dhe universitetet (mbikëqyrja dhe pajisjet)

Sa i takon masës për ofrimin e subvencioneve për NMVM-të dhe universitetet, e cila synonte mbështetjen e pagave dhe pajisjeve për kërkim-zhvillim, konstatohet se kjo masë nuk është realizuar gjatë vitit 2025. Ndonëse kjo ndërhyrje ishte parashikuar të financohej përmes mbulimit të gap-it financiar (fondet e donatorëve), mungesa e sigurimit të këtyre burimeve të jashtme ka sjellë mospërbushjen e aktivitetit.

Indikatorët

Masa	Treguesit e parashikuar (për periudhën 2021-2027)	Realizimi 2025
Skema e mbështetjes për zhvillimin e kapitalit njerëzor bashkëpunues	- 150 përfitues (të paktën 40% gra) - 100 NVM që punësojnë talente përtej kohëzgjatjes së mbështetjes	Pa realizuar

1.3.2 Masa “Sensibilizimi dhe përfshirja e bizneseve në reformat e sistemit të VET-së”

Institucioni udhëheqës: Ministria përgjegjëse për politikën e punësimit

Institucion kontribues: Ministria përgjegjëse për ekonominë

Aktiviteti 1.3.2.1: Ndërgjegjësimi dhe përfshirja e bizneseve në prezantimin e modelit të VET-së në periudhën 2025–2027.

Bashkëpunimi ndërmjet të gjithë aktorëve, përfshirë edhe biznesin privat, në zhvillimin e vazhduar profesional të mësimdhënësve të kulturës profesionale është shumë i rëndësishëm për të garantuar procese cilësore në ofruesit e AFP-së, duke ofruar metoda mësimore inovatore dhe përfshirjen e praktikave pozitive të zhvillimit të teknologjive të avancuara të biznesit në mësimdhënie.

Mësimdhënësi është aktori dhe faktor kyç për të çuar përpara të gjitha iniciativat e ndërmarra në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar për përgatitjen cilësore të individëve (të rinj dhe të rritur) për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm dhe të gjelbër të ekonomisë së vendit.

Gjatë vitit 2025 AKAFPK është mbështetur në rekomandimet e komiteteve sektoriale të “Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit” (TIK) dhe “Mikpritjes dhe Turizmit” në të cilët janë identifikuar nevoja për 5 kualifikime profesionale në drejtimin TIK” dhe 4 kualifikime profesionale në drejtimin “Hoteleri – Turizëm.

AKAFPK ka hartuar 5 standarde të profesioneve dhe 5 standarde të kualifikimeve profesionale në drejtimin TIK”, niveli II-V të KSHK-së, si dhe 4 standarde të profesioneve dhe 4 standarde të kualifikimeve profesionale në drejtimin “Hoteleri - Turizëm”, niveli II-V të KSHK-së, të identifikuara nga Komitetet Sektoriale përkatëse, duke pasuruar Katalogun Kombëtar të Kualifikimeve Profesionale, për nivelet II-V të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve me kualifikime të reja, në përputhje me nevojat e tregut të punës.

Indikatorët

Masa	Treguesit e parashikuar (për periudhën 2025-2027)	Realizimi 2025
Sensibilizimi dhe përfshirja e bizneseve në reformat e sistemit të VET-së	- Numri i aktiviteteve, në të cilat prezantohen/diskutohet me bizneset modeli i VET-së. - Numri i kurrikulave të rishikuara/të reja me përfshirjen e bizneseve në studimet dhe konsultime.	Janë mbajtur takime konsultative me Komitetet Sektoriale të “Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit” (TIK) dhe “Mikpritjes dhe Turizmit”, ku biznesi ka ofruar rekomandime për nevojat e tregut. Janë hartuar 9 standarde të reja profesionale dhe 9 standarde kualifikimesh profesionale (5 në drejtimin TIK dhe 4 në Hoteleri-Turizëm), të niveleve II-V të KSHK-së, duke pasuruar Katalogun Kombëtar të

		Kualifikimeve në përputhje me kërkesat e biznesit.
--	--	--

1.3.3 Masa “Sistemi i parashikimit të nevojave për aftësi”

Institucioni udhëheqës: Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive.

Institucion kontribues:

- AKAFPK,
- Ministria përgjegjëse për ekonominë,
- MA,
- Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë,
- Shoqatat e biznesit dhe sektori privat.

Studimi i Nevojave për Aftësi (SNA)

Në fund të vitit 2024 nisi procesi i zbatimit të SNA. Gjatë periudhës nëntor 2024- dhjetor 2025 në kuadër të këtij studimi u zhvilluan një sërë aktiviteteve si:

- a. Pasurimi i të dhënave të kontaktit të kampionit të përzgjedhur për kryerjen e studimit dhe dërgimi e tyre sipas rajoneve
- b. Konfirmimi i pyetësorit dhe letrës informuese për subjektet objekt i intervistimit;
- c. Informimi, trajnimi dhe mbështetja e specialistëve përgjegjës në funksion të mbledhjes së të dhënave;
- d. Mbledhja e të dhënave nëpërmjet pyetësorit;
- e. Monitorimi i ecurisë së realizimit të procesit dhe plotësimit të të dhënave nëpërmjet platformës elektronike
- f. Verifikimi i cilësisë së të dhënave të mbledhura
- g. Analiza e rezultateve dhe hartimi raportit.

Aktualisht pritët publikimi i raportit dhe lancimi i gjetjeve.

Analizat Rajonale të Tregut të Punës për 2025

Në kuadër të planifikimit afatshkurtër të AFP, gjatë periudhës maj- qershor 2025 u realizuan 12 analizat e rajonale të tregut të punës të cilat u dërguan për njohje dhe në institucionet e AKPA.

Analizat morën në konsideratë numrin e VLP-ve të shpallura në sistemin e shërbimeve të punësimit sipas profesioneve për secilën nga 9 kategoritë profesionale.

Gjithashtu numri i nxënësve dhe kursantëve në VET u zërthye sipas profesioneve për secilën nga 9 kategoritë profesionale.

Rezultatet e përputhjes së kërkesës (VLP) dhe ofertës së AFP sipas profesioneve dhe nivelet e punësueshmërisë së kurseve/ drejtimeve të shkollave/ programeve të nxitjes së punësimit të dala nga rezultatet e gjurmimeve u analizuan për identifikimin e mospërputhjeve dhe nxjerrjen e rekomandimeve për zyrat e punësimit, qendrat e formimit profesional dhe shkollat e mesme

profesionale.

Analizat janë shfrytëzuar në funksion të ndërtimit të planeve vjetore të shkollave mesme profesionale. AKPA në vijim të zbatimit të politikave të punësimit dhe aftësive ofron 2 programe që kanë një orientim të veçantë të zhvillimi dhe mbështetja e aftësive sipërmarrëse. Së pari ofrohet programi i formimit profesional (kurs formimi profesional me kohëzgjatje 250 orë mësimore) “Sipërmarrje dhe menaxhim i biznesit të vogël”. Gjithashtu në kuadër të mbështetjes së sipërmarrjeve të vogla AKPA zbaton programin e nxitjes së punësimit nëpërmjet vetëpunësimit (V.K.M 348 Programi i vetëpunësimit) i cili mbështet me një shumë deri në 1,000,000 lekë punëkëkuesit e papunë (gjatë vitit 2025 është dyfishuar vlera e financimit) që dëshirojnë të vetëpunësohen nëpërmjet hapjes së një biznesi të ri. Pjesë e paraprake e programit është ndjekja nga ana e aplikantëve e një kursi afatshkurtër (“Për sipërmarrjen dhe zhvillimin e planeve të biznesit”) të ofruar nga qendrat e formimit profesional, mbi zhvillimin e një sipërmarrje me fokus të veçantë hartimin e planit të biznesit.

Të dhënat e vitit 2025:

- Kursi profesional “Sipërmarrje dhe menaxhim i biznesit të vogël” është ndjekur nga **358** kursantë;
- Kursi afatshkurtër “Për sipërmarrjen dhe zhvillimin e planeve të biznesit” pjesë e programit të vetëpunësimit, referuar kërkesave planifikohet të ketë **344** kursantë.

Indikatorët

Masa	Treguesit e parashikuar (për periudhën 2021-2027)	Realizimi 2025
Sistemi i parashikimit të nevojave për aftësi	- Sistemi i parashikimit i zhvilluar/implementuar (deri në vitin 2022) - 3 raporte parashikimi	Proces. Aktualisht pritët publikimi i raportit dhe lancimi i gjetjeve.

1.3.4 Masa “Vlerësim periodik i nevojave për trajnim”

Institucioni udhëheqës: AIDA

Institucion kontribues:

- AIDA,
- Ministria përgjegjëse për ekonominë,
- AKPA,
- Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë,

- Shoqatat e biznesit.

Aktiviteti 1.3.4.1: Dizajnimi i shërbimeve mbështetëse duke përfshirë faqen e internetit, materialet e komunikimit

Janë publikuar në mënyrë periodike broshurat sektoriale nga ana e AIDA.

Aktiviteti 1.3.4.2: Ofrimi i shërbimeve mbështetëse dhe kryerja e rregullt e VNT nga një specialist i ANT

Në muajin Mars 2026, AIDA, do të hartojë pyetësin e nevojave për trajnim të bizneseve. Është realizuar pyetësi, dërguar 20 bizneseve startup.

Indikatorët

Masa	Treguesit e parashikuar (për periudhën 2021-2027)	Realizimi 2025
Vlerësim periodik i nevojave për trajnim	- 1 vlerësim i nevojave për trajnim çdo vit - 250 SME të asistuar çdo vit	Në proces, në muajin Mars 2026, AIDA, do të hartojë pyetësin e nevojave për trajnim të bizneseve.

V. Vlerësimi i shkallës së zbatimit të Strategjisë (SBZHI) për vitin 2025

Monitorimi i ecurisë së Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve për vitin 2025 është realizuar përmes një analize të dyfishtë, duke kombinuar shkallën e realizimit të masave (output-et) me arritjen e objektivave përmes indikatorëve të performancës (outcome-et).

1. Realizimi sipas Masave të Planit të Veprimit. Nga pikëpamja operationale, shkalla e zbatimit të masave për vitin 2025 vlerësohet në 77.7 % (18 masa gjithsej, 1 e pa realizuar dhe 3 në proces). Ky tregues referon se një pjesë e nismave administrative, si hartimi i akteve ligjore, organizimi i fushatave promovuese dhe menaxhimi i skemave të granteve, janë përmbushur sipas afateve. Niveli i realizimit advokon për një koordinim ndërmjet institucioneve zbatuese (si AIDA, AKKSHI, Agjencia Startup Albania, etj.).
2. Realizimi sipas Indikatorëve të Performancës: Në nivel strategjik, shkalla e zbatimit e llogaritur përmes indikatorëve të performancës rezulton në 75.5 %. Sipas secilës shtyllë ecuria paraqitet si vijon:

➤ Shtylla 1: Investimet dhe Ndërkombëtarizimi

Kjo shtyllë ka performancën më të lartë, ku shumë indikatorë kanë tejkaluar parashikimet fillestare.

Indikatori (KPI)	Target 2025	Realizimi Faktik	% e Realizimit
Fushata specifike të targetimit (Outreach)	1	2	200%
Shërbimi pas kujdesit (After-care)	43	112	260%
Memorandume bashkëpunimi (MoU)	3	12	400%
Sipërfaqe tokë e zhvilluar/përdorur	20 - 30 ha	62 ha	200%
Rezidentë aktivë në zonë	20 rezidentë	50 rezidentë	250%
Vlerësimi i Diplomacisë Ekonomike	Reformë 2025-2027	Në proces	75%
Programi i eksportit	Strategjia e eksportit e zhvilluar deri në vitin 2022	Miraturar	100 %
Iniciativa e zhvillimit të biznesit elektronik	300 biznese përfituese (43 cdo vit)	30 biznese përfituese	69.7 %
Mesatarja			93.1 %

➤ **Shtylla 2: NMVM-të dhe Inovacioni**

Kjo shtyllë tregon një ecuri pozitive në aspektin e mbështetjes financiare, por me sfida në aspektin e trajnimeve dhe ngritjes së kapaciteteve.

Indikatori (KPI)	Target 2025	Realizimi Faktik	% e Realizimit
Përfitues nga fondet e NMVM (AIDA)	60	85	141%
Lidhja mes NMVM-ve dhe startup-eve	24 aktivitete ndërgjegjëse me start up-e dhe bizneseve NMVM	69 aktivitete të dedikuara startup-eve, 19 lancime produktesh, si dhe 4 sesione virtuale mentorimi dhe 1 sesion fizik mbi sigurinë kibernetike.	287%
Akresi në programet Bashkimit Evropian në fushën e biznesit	I hapur (Sipas kërkesës)	105	100 %
Gratë sipërmarrëse përfituese	30%	44%	146%
Mentorë nga diaspora të angazhuar	I hapur (Sipas kërkesës)	30	100%

Mbështetja e Konsorciumeve (PTI)	10 Projekte	14 Projekte	140%
Trajnime për NMVM-të (Aktivitete)	12	2	16.6%
Numri i bizneseve pjesëmarrëse në trajnime	300 biznese	60 biznese	20 %
Mesatarja			79.5 %

➤ Shtylla 3: Kapitali Njerëzor

Kjo është shtylla me realizimin më të ulët, e cila ka ndikuar drejtpërdrejt në zbritjen e normës totale të strategjisë në 78%.

Indikatori (KPI)	Target 2025	Realizimi Faktik	% e Realizimit
Skema e mbështetjes për zhvillimin e kapitalit njerëzor bashkëpunues	150 përfitues (të paktën 40% gra) 100 NVM që punësojnë talente përtej kohëzgjatjes së mbështetjes	0	0 %
Sistemet e parashikimit të nevojave për aftësi	Raport parashikimi	Proces	50 %
Vlerësimi i nevojave (Raporti)	1 vlerësim/vit	Në proces (Hartimi i pyetësorit)	25 %
SME të asistuar	250 SME	Në proces	50 %
Aktivitetet e sensibilizimit	I hapur (Sipas kërkesës	Takime me Komitetet Sektoriale (TIK & Turizëm)	100%
Kurrikulat/Standardet e reja	I hapur (Sipas kërkesës	9 standarde profesionale & 9 kualifikimesh (Total 18)	100%
Mesatarja			54.1 %